

PAULLINA SIMONS  
**TATIANA DHE ALEKSANDRI**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



Paullina Simons

TATIANA DHE ALEKSANDRI

Roman

Përktheu nga origjinali anglisht  
Platon Pulla

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2015

Titulli në origjinal: Paullina Simons, *Tatiana and Alexander*.

Ky libër u botua në marrëveshje me HarperCollins *Publishers*, Inc.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi  
Përkujdesja grafike: Elida Stafa  
Kopertina: Platon Pulla

ISBN 978-9928-4291-6-2

© Paullina Simons 2003  
© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893  
Fax: +355 4 22 40 117  
E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## VLERËSIME

“Ky libër ka gjithçka që kërkon një lexues i pangopur romancash: një protagonist të guximshëm, të talentuar dhe të pashëm. Një histori dashurie që të lë pa frymë.”

DAIL MAIL

“Një nga autoret femra më ekzaltuese... Paullina Simons ndërthur në mënyrë të përkryer karaktere me të cilat lexuesi e ka të lehtë të identifikohet dhe në një libër të cilin e ka të vështirë ta lëshojë nga dora.”

WOMAN & HOME

“Nëse je duke kërkuar një histori epike, në të cilën të zhytesh, dhe të ka marrë malli për pak ‘Doktor Zhivago’, atëherë ky libër është për ty.”

CLOSER

“Nuk do ta shohësh më jetën në të njëjtin këndvështrim... eksperiencia dhimbjeje, dëshpërimi dhe tradhtie mënjanohe nga momente gëzimi verbues, dashurie dhe, mbi të gjitha, miqësie. Lexo edhe qaj – me kuptimin e plotë të fjalës.”

COMPANY



## FALËNDERIME

Dua të falënderoj, edhe pse me vonesë, Lerry Brantley-n, zërin e ushtrisë, që kaloi orë të tëra duke më shpjeguar gjëra të cilat nuk mund t'i kisha mësuar vetë.

Tracy Brantley-n, gruan e tij dhe miken time të mirë, e cila, në një mënyrë shumë miqësore, më dha atë për të cilën kisha më shumë nevojë në fillim, duke qarë në pasazhet e duhura dhe duke i adhuruar Tanjën dhe Surën për të gjitha arsyet e duhura.

Irene Simons-in, vjehrrën time të parë, që më dha emrin nën të cilin shkruaj librat e mi.

Elaine Ryan-in, vjehrrën time të dytë, që më dha djalin e saj të përsosur.

Radik Tikhomirov-in, mikun e babait tim për pesëdhjetë vjet, që fotokopjoi ditarët e të mbijetuarve të bllokadës në bibliotekën e Shën Petërburgut dhe që më dërgoi qindra faqe në rusisht.

Robert Gottlieb-in, mikun tim rusodashës që u gjend gjithmonë aty për mua, dhe Kim Whalen-in, për një dekadë pune intensive.

Jane Barringer-in që, me fytyrën dhe durimin e shenjtë të Melanisë së Olivia Dehavilland-it te *Bashkë me Erën*, u zhyt në fjalët e *Kalorësit të Bronztë* – tri herë! – duke e bërë kështu një libër më të mirë.

Joy Chamberlain-in, redaktore e jashtëzakonshme, nënë, notare, që sheh e ndien dhe kupton gjithçka dhe gjithmonë ka frikë të më japë lajme të këqija.

Nick Seyers-in, mikun tim, ish-redaktorin dhe ish-botuesin tim, i cili më tha një herë, pasi kishte pirë pak si shumë verë, se edhe sikur të shkruaja fletët e verdha ai do t'i botonte. Aah!


Pavla Salacova-n, e cila punon aq shumë për të ma bërë jetën më të lehtë, sa që më jep përshtypjen se ka njëzet duar.

Dhe burrin tim të dytë dhe të fundit, Kevin - je i paparë.





*Sërish për gjyshërit e mi të dashur,  
nëntëdhjetë e tetë dhe nëntëdhjetë e katër vjeç, të cilët vazhdojnë të  
mbjellin tranguj, të ujin lulet dhe të jetojnë të lumtur,  
si dhe për mikun tonë të mirë, Anatoli Studenkov,  
që mbeti në Rusi dhe nuk pati të njëjtin fat.*







*Nën dritën e zbehtë të hënës  
Hipur lart mbi kalin e tij të egër  
Kokën lart mes jehonash e britmash  
Kalorësi i Bronztë po të ndjek.*

*Dhe gjatë gjithë asaj nate të gjatë, pavarësisht  
Se ç'rrugë mund të marrë fukarai i çmendur  
Aty do të godasë me trokëllimë të rëndë  
Kalorësi i Bronztë në zgjimin e tij.*

ALEKSANDËR PUSHKIN



## PROLOG

*Boston, dhjetor 1930*

ALEKSANDËR Barringtoni po qëndronte para pasqyrës dhe përpiquej të rregullonte shaminë e tij të organizatës “Këlyshët e Ujqërve”. Por nuk mund ta shkëpuste vështrimin nga fytyra e tij, që ishte e vrenjtur si rrallë ndonjëherë. Duart e tij po përpiqeshin të lidhnin shaminë me ngjyrat gri e të bardhë, por nuk ia dolën dot.

I ktheu shpinën pasqyrës, i hodhi një vështrim dhomës dhe psherëtiu. Nuk ishte e madhe, dysheme prej druri, tapiceri ngjyrë kafe, një krevat dhe një komodinë.

Por dhoma nuk kishte rëndësi. Nuk ishte dhoma e tij. Ishte një dhomë që e kishin marrë me qira dhe mobilet i përkisnin pronares që banonte në katin e poshtëm. Dhoma e tij e vërtetë nuk ishte në Boston, por në Barrington, dhe i mungonte ajo dhomë. Nuk i kishte pëlqyer asnjë nga gjashtë dhomat e tjera ku kishte jetuar gjatë dy viteve të fundit, që atëherë kur i ati shiti shtëpinë e tyre dhe e largoi Aleksandrin nga Barringtoni dhe nga vitet e tij të fëmijërisë.

Tani do të largoheshin edhe nga këto dhoma. Nuk kishte rëndësi.

Ose më saktë, *kjo nuk kishte rëndësi.*

Aleksandri u pa përsëri në pasqyrë. E ngjeshi ballin pas saj dhe mori frymë thellë.

*Po tani, Aleksandër? - pëshpëriti me vete.*

Tedi, shoku i tij më i ngushtë, faktin që Aleksandri do të ikte jashtë shtetit, e konsideronte si gjënë më emocionuese.

Por Aleksandri nuk ishte dakord me të.

Nga dera gjysmë e hapur dëgjoji prindërit e tij që po grindeshin. Nuk i kushtoi rëndësi. Tensioni i ditëve të fundit i bënte të grindeshin shpesh. Pak më vonë, i ati, Harold Barrington, hyri në dhomë dhe i tha:

- Gati je, biri im? Makina po na pret. Kanë ardhur dhe shokët e tu për të të përshëndetur. Madje Tedi më pyeti nëse mund të marr atë në vendin tënd. Haroldi buzëqeshi. - I thashë se ndoshta do ta bëj. Si thua? Do të doje të shkëmbeheshe me Tedin? Të jetosh me mamanë e tij të çmendur dhe me babain e tij akoma më të çmendur?

- Po, se prindërit e mi janë tejet të arsyeshëm, - foli Aleksandri.

Haroldi ishte i hollë dhe kish një gjatësi mesatare. Ajo që e dallonte nga të tjerët ishte nofulla katrore, që përfundonte me një mjekër të mprehtë. Megjithëse dyzet e tetë vjeç, kishta akoma flokë të dendur ngjyrë gështenjë, që sapo kishin filluar të thinjeshin dhe sy ngjyrë blu të errët. Aleksandrit i pëlqente ta shihte kur ishte në humor, se atëherë sytë e tij humbisnin paksa nga serioziteti i tyre.

Atë çast, Xhein Barrington, mamaja e Aleksandrit, e shtyu Haroldin tutje dhe hyri në dhomë. Kishte veshur fustanin e saj më të bukur prej mëndafshi dhe një kapelë rrumbullake të bardhë.

- Harri, lëre djalin të qetë! Nuk e shikon që po përpiqet të bëhet gati? Makina mund të presë pak. Po ashtu dhe Tedi me Belindën, - zëri i Xhenit kishte akoma disa gjurmë të theksit të saj melodioz italian, që nuk kishte mundur ta humbiste, që kur kishte shkuar në Amerikë në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare. Rregulloi flokët e saj të zinj e të gjatë dhe shtoi:

- Këtë Belindën nuk e simpatizova kurrë.

- E di, nënë, - iu përgjigj Aleksandri. - A nuk po largohemi nga Amerika pikërisht për këtë?

Aleksandri i kishte kthyer shpinën prindërve dhe po i shikonte nga pasqyra. I ngjante më shumë së ëmës. Për sa i përkiste karakterit, mendonte se i ngjante më shumë të atit. Nuk e dinte. E ëma e zbaviste, ndërsa babai e ngatërronte.

- Baba, gati jam, - tha Aleksandri.

Haroldi iu afrua dhe e kapi nga supet.



- Dhe ti mendoje se me “Këlyshët e Ujqërve” do të mbarojë aventura. Aventura me “Këlyshët e Ujqërve”.

- Baba, - iu drejtua ai duke parë imazhin e tij në pasqyrë, - nëse gjërat nuk shkojnë mirë, mund të kthehemi përsëri këtu, apo jo? Mund të kthehemi në... - ndaloi për një çast, mori frymë thellë, derisa zëri i tij rifitoi qëndrueshmërinë dhe shtoi: - Në Amerikë?

Meqenëse i ati nuk iu përgjigj, Xheini iu afrua nga ana tjetër, dhe Aleksandri u gjend midis tyre. E ëma, megjithëse kishte veshur këpucë me takë të ulët, ishte gjashtë a shtatë centimetra më e gjatë se i ati i tij, i cili e kalonte Aleksandrin pothuajse dyzet e pesë centimetra.

- Harold, thuaji djalit të vërtetën, - tha Xheini. - Ka të drejtë ta dijë. Tashmë është i rritur.

- Jo, Aleksandër, - tha Haroldi. - Nuk mund të kthehemi dot më. Bashkimi Sovjetik do të bëhet shtëpia jonë e përhershme. Nuk ka më vend për ne në Amerikë.

Aleksandri donte t'i thoshte se për të kishte vend dhe vendi i tij ishte Amerika. Tedi dhe Belinda kishin qenë shokët e tij që në moshën trevjeçare. Barringtoni ishte një qytet i vogël, me shtëpi të bardha dhe grila të errëta, me tri kisha me kambanore dhe me një rrugë kryesore të shkurtër sa katër blloqe ndërtesash, që e përshkonte qytetin nga fillimi deri në fund. Në pyjet përreth kishte kaluar i lumtur vitet e tij të fëmijërisë. Tashmë e dinte që i ati nuk donte t'i dëgjonte këto, kështu që nuk foli.

- Aleksandër, - foli përsëri Haroldi, - mamaja jote dhe unë jemi plotësisht të sigurt se ajo që po bëjmë është më e mira për familjen tonë. Për herë të parë në jetën tonë, më në fund, jemi në gjendje të bëjmë atë çka besojmë. Tani idealet komuniste nuk do t'i mbështesim vetëm në fjalë boshe. Është e lehtë të flasësh për ndryshim kur bën një jetë krejtësisht komode, apo jo? E, pra, tani do të jetojmë sipas besimit tonë. Ti e di që gjatë gjithë jetës sime për këtë kam luftuar. Edhe nëna jote gjithashtu. Na ke parë.

Aleksandri tundi kokën. Po, i kishte parë. Kishte parë babanë dhe nënën e tij të arrestoheshin për shkak të parimeve të tyre. Kishte vizituar të atin e tij në paraburgim. Madje, në shkollë, shokët e klasës talleshin me të dhe shpesh ishte futur në sherr për shkak të parimeve të të atit. Kishte parë të ëmën të qëndronte në krah të tij nëpër protesta dhe demonstrata. Kishte shkuar bashkë me ta

në Uashington për të shfaqur bindjet komuniste para Shtëpisë së Bardhë. I kishin arrestuar edhe atje. Kishte qenë vetëm shtatë vjeç kur kishte kaluar një natë në qendrën e paraburgimit për të mitur. Por nga ana tjetër, ishte i vetmi fëmijë në Barrington që kishte parë Shtëpinë e Bardhë.

Kishte menduar se këto sakrifica mjaftonin. Dhe një sakrificë akoma më të madhe kishte konsideruar faktin që ishin shkëputur nga familja dhe kishin hequr dorë nga shtëpia që ishte banesa e Barringtonëve për tetë breza. Kishte menduar se jetesa në dhoma me qira në Bostonin e zhurmshëm dhe gjithë pluhur, duke përhapur ideologjinë socialiste, ishte sakrificë e mjaftueshme.

Por, me sa dukej, të gjitha këto nuk mjaftonin.

Nëse do të donte të ishte i sinqertë me veten e tij, Aleksandri duhej të pranonte se emigrimi në Bashkimin Sovjetik ishte një surprizë e papëlqyeshme për të. Por i ati besonte se atje e kishin vendin, se atje asnjëri nuk do ta përqshte Aleksandrin, se atje do të ishin të gjithë të mirëpritur, se askush nuk do t'i ndiqte penalisht e as nuk do të tallej me ta. Atje do të ndërtonin jetën e tyre, e cila, nga “e pakuptimtë” që ishte tani, do të merrte kuptim. Në Rusinë e re pushteti i takonte njerëzve të punës dhe shumë shpejt punëtori do të bëhej mbret. Besimi i të atit i mjaftonte Aleksandrit.

E ëma e puthi në ballë duke i lënë shenjën e buzëkuqit, të cilën e fshiu me dorë.

- Biri im i dashur, - i tha ajo, - ti e di që babai yt dëshiron që ti të rritesh me parimet e duhura, apo jo?

- Nënë... kjo nuk ka të bëjë me *mua*, - iu përgjigj Aleksandri disi i zemëruar.

- Jo, - u hodh i ati duke e mbajtur vazhdimisht nga supi. - Pikërisht për ty po i bëjmë të gjitha, Aleksandër. Je ende njëmbëdhjetë vjeç, por shumë shpejt do të bëhesh burrë. Dhe, meqë ke vetëm një jetë, vetëm një lloj burri mund të bëhesh. Po shkojmë në Bashkimin Sovjetik që të bëhesh burri që duhet të bëhesh. *Ti*, biri im, je trashëgimtari im i vetëm në këtë botë.

- Baba, dhe në Amerikë ekzistojnë burra, - shtoi Aleksandri. - Herbert Huver, Udrou Uillson, Kalvin Kulixh.

- Po, por nuk janë burra të mirë. Amerika nxjerr burra lakmitarë dhe egoistë, arrogantë dhe hakmarrës. Nuk dua që ti të bëhesh i tillë.

- Aleksandër, - ndërhyri e ëma, - ne duam që karakteri yt të ketë cilësi të tilla, që njerëzit në Amerikë nuk i kanë.

- Pikërisht, - tha Haroldi. - Amerika i bën burrat të butë.

Aleksandri bëri një hap pas, pa e hequr vështrimin nga shëmbëlltyra e tij. Edhe para se të vinin ata, ai po shikonte veten e tij dhe e pyeste: Ç'loj burri do të bëhem kur të rritem?

Duke përshëndetur të atin, i tha:

- Mos u shqetëso, baba! Do të jesh krenar për mua. Nuk do të jem as lakmitar e as egoist, as arrogant e as hakmarrës. Do të bëhem një prej burrave më të fortë. Ikim. Jam gati.

- Aleksandër, unë nuk dua që të bëhesh burrë i fortë, por burrë i mirë, - iu përgjigj i ati. - Më i mirë se unë.

Duke ikur të gjithë bashkë, Aleksandri u kthye dhe i hodhi një vështrim të fundit pasqyrës. *Nuk dua ta harroj këtë djalë*, mendoi me vete, *ndoshta ndonjëherë do të më duhet ta gjej përsëri*.

### *Stokholm, maj 1943*

*Gjendem në udhëkryq*, mendoi Tatiana tetëmbëdhjetëvjeçare kur u zgjua një mëngjes të ftohtë vere. *Nuk mund të jetoj më kështu*. U ngrit, u la, rregulloi shtratin, futi librat dhe rrobat e saj të pakta në çantën e shpinës, dhe u largua duke e lënë dhomën të pastër, sikur të mos kishte jetuar aty më shumë se dy muaj.

Perdet e bardha u tundën pas saj.

Ajo nuk ndihej e qetë. Në murin pas tavolinës varej një pasqyrë ovale. Para se të ikte, ndaloi të krihej dhe u pa në pasqyrë. Ajo që pa ishte një fytyrë të cilën nuk e njihte më. Nuk kishte më atë formën rrumbullake si të një bebeje. Tashmë ishte një fytyrë thananike me mollëza të theksuara, ballë të gjerë, nofull katrore dhe buzë të mbledhura. Plaga që kishte në faqe nga xhami i thyer ishte shëruar dhe tashmë kish mbetur vetëm një vijë ngjyrë rozë. Edhe qukat pothuajse ishin zhdukur. Ato që nuk njohu fare Tatiana, ishin sytë e saj. Ato sy jeshilë, që dikur kishin një ngjyrë të gjelbër vezulluese, kishin humbur midis tipareve të zbehta dhe i dukej sikur tashmë ishin thjesht një barrierë e ftohtë prej kristali, midis të huajve dhe shpirtit të saj. Nuk mund të shihte njeri në sy. As veten nuk e shihte

dot më. Mjaftonte një vështrim drejt detit të gjelbër dhe ishte e qartë se çfarë fshihej pas asaj fasade të brishtë.

Tatiana krehu flokët e saj prej platini, që i arrinin deri te supet. Nuk i urrente më flokët e saj. Si mund t'i urrente përderisa Aleksandri i dashuronte kaq shumë?

Nuk do të mendonte për flokët e saj. Donte t'i priste, të qethej si qengji para se ta thernin, t'i shkulte të bardhat nga sytë e saj, të shkulte dhëmbët nga goja dhe damarët nga fyti.

I bëri flokët gërshet dhe e lidhi në majë të kokës. Pastaj vuri një shami, që të tërhiqte sa më pak vëmendjen, edhe pse në Suedi kishte shumë vajza bionde dhe mund të humbiste lehtë në turmë.

Duhej të ikte, por nuk gjente forcë brenda vetes. Brenda trupit mbante foshnjën e saj, por mund ta lindte shumë lehtë këtu, ashtu si mund ta lindte dhe në Amerikë. Edhe më lehtë akoma. Mund të qëndronte. Atëherë nuk do t'i duhej të përshkonte një vend të panjohur, të gjente një traget që ta çonte në Angli dhe pastaj të kalonte gjithë oqeanin për të arritur në Shtetet e Bashkuara në mes të një lufte botërore. Gjermanët hidhnin çdo ditë në erë vaporë në detrat veriore, silurët e tyre shpërthenin në nëndetëset e Aleatëve duke mbushur me tym e flakë Baltikun, Arktikun dhe Atlantikun. Por në Stokholm mund të qëndronte e sigurt.

Çfarë *kishte* bërë deri tani?

Qëndronte aty dhe shihte gjithkund Aleksandrin.

Kudo që shkonte, kudo ku qëndronte, sapo kthente kokën djathtas, ai gjendej aty, i gjatë, i veshur me uniformën e oficerit, me armën të varur në sup, duke e vështruar e duke buzëqeshur. Dhe ajo zgjaste dorën që ta prekte - dhe kapte ajrin, prekte jastëkun e bardhë mbi të cilin shihte fytyrën e tij. Pastaj kthehej nga ai, i priste bukën dhe ulej në stol duke parë se si kalonte rrugën për të ardhur drejt saj. Duke ecur nëpër rrugë, shkonte pas suedezëve me shpatulla të gjera, që ecnin me hapa të mëdhenj, dhe shihte sytë e të panjohurve që i dukeshin si të Aleksandrit. Por sapo puliste sytë, ai largohej. Dhe atëherë ulte vështrimin përtokë dhe largohej.

Ngriti sytë drejt pasqyrës. Pas saj qëndronte Aleksandri. I largoi flokët nga qafa dhe u përkul mbi të. Por ajo nuk ndjeu as aromën, as prekjen e buzëve të tij. Vetëm sytë e saj po e vështronin.

Mbylli sytë.

Vajti në kafenenë “Spivak” dhe hëngri mëngjesin e saj të zakonshëm: dy racione proshutë, dy filxhanë kafe të zezë dhe tri vezë të ziera. Bëri sikur po lexonte gazetën angleze, të cilën e kishte blerë në kioskën pranë portit, edhe pse fjalët e shtypura kërcenin para syve të saj, aq sa nuk mund t’i kuptonte. Pasditeve, që ishte paksa më e qetë, Tatiana mund të lexonte më mirë.

U largua nga kafeneja dhe vajti drejt molit industrial. U ul në një stol dhe vështroi suedezin që po ngarkonte disa barka maune me letër për t’i transportuar drejt Helsinkit. E kishte ndjekur shumë herë dhe e dinte se pas pak do të shkonte të bisedonte me miqtë e tij që punonin pesëdhjetë metra më poshtë. Do të tymoste një cigare, do të pinte një filxhan të vogël me kafe dhe do të tymoste sërish edhe një cigare tjetër. Do të largohej nga vendi i punës, afërsisht pas trembëdhjetë minutash. Dhe anija maune do të mbetej pa njeri, me dërrasën gjithnjë në pozicionin që e bashkonte me tokën. Pastaj do të kthehej, do të vazhdonte ta ngarkonte dhe pas gjashtëdhjetë e dy minutash do të shfaqej kapiteni, do të zgjidhnin litarët dhe anija do të nisej për në Helsinki nëpërmjet Baltikut të ngrirë.

Tatiana i kishte ndjekur të gjitha këto për shtatëdhjetë e pesë ditë.

Helsinki ishte vetëm katër orë larg Viborgut. Këtë e kishte mësuar nga gazetatat angleze, të cilat i blinte çdo ditë, se Viborgu - për herë të parë, që nga viti 1918 - ishte në duart e sovjetikëve. Ushtria e Kuqe i kishte rimarrë territoret ruse të Karelias nga finlandezët. Me një varkë përmes detit drejt Helsinkit, me një kamion përmes pyjeve drejt Viborgut, dhe ajo mund të ishte përsëri në duart e sovjetikëve.

*- Ndonjëherë dua që të mos jesh kaq kokëfortë, - tha Aleksandri.*

*Ai kish arritur të merrte një leje treditore. Ishin në Leningrad. Hera e fundit që ishin në Leningrad bashkë, hera e fundit për gjithçka.*

*- Kjo që thua është sikur t’i thotë tigani tenxheres që është e zezë.*

*- Po. Do të doja që tenxherja të mos ishte kaq e zezë. Ai shfryu me inat. - Ekzistojnë disa gra, - tha ai, - të cilat u binden burrave të tyre. I kam parë. Kanë burra që...*

*Ajo e gëdhulsi. Ai nuk qeshi.*

*- Në rregull. Më thuaj, çfarë të bëj, - tha ajo duke ulur pak zërin. - Do të bëj si të më thuash ti.*

*- Largohu nga Leningradi dhe kthehu në Lazarevo menjëherë, - i tha ai. - Shko aty, që të jesh e sigurt.*

*Ajo rrotulloi sytë dhe pëshpëriti:*

*- Eja tani, e di që mund ta luash këtë lojë.*

*- E di që mundem, - ia ktheu Aleksandri, i cili ish ulur mbi divanin e vjetër të prindërve të saj. - Thjesht nuk dua. Ti nuk mund të më bindesh për gjërat e rëndësishme...*

*- Këto nuk janë gjëra të rëndësishme, - tha Tatiana. Ai u përkul mbi të dhe ia vendosi duart mbi të sajat. - Nëse NKVD-ja do të vijë për mua, do ta kuptoj se ti do të më kesh lënë dhe do të shkoj e lumtur drejt pushkatimit. Shtrëngoi duart dhe vazhdoi: - Do të shkoj drejt pushkatimit si gruaja jote dhe nuk do të pendohem për asnjë çast që kaluam bashkë. Më lër, pra, t'i shijoj këto ditë këtu me ty. Më lër të të nuhas përsëri, të të shijoj përsëri, të të puth përsëri, - pëshpëriti Tatiana. - Tani, luaj me mua lojën time, sado e trishtë që të jetë. Të shtrihemi bashkë në Leningradin dimëror. Luaj me mua këtë mrekulli, të shtrihem pranë teje. Më thuaj, çfarë do që të bëj dhe do ta bëj.*

*Aleksandri e tërhoqi nga dora.*

*- Eja këtu. Ai hapi krahët. - Ulu në prehrin tim.*

*Ajo iu bind.*

*- Tani, vendosi duart e tua mbi fytyrën time.*

*Iu bind përsëri.*

*- Vendosi buzët e tua mbi sytë e mi.*

*Përsëri iu bind.*

*- Puth ballin tim.*

*Iu bind.*

*- Puth buzët e mia.*

*Iu bind. Iu bind.*

*- Tanja...*

*- Shët.*

*- A nuk e shikon se po thyhem?*

*- Ah, - pëshpëriti ajo. - Epo, atëherë, je akoma i plotë.*

*Ajo rrinte ulur dhe vështronte nga porti në ditë me diell dhe në ditë me shi. Ose në ditë me mjegull - që pothuajse çdo mëngjes në orën tetë të gjitha ditët ishin me mjegull.*

*Bënte ftohtë. Në skelë vinte erë peshku dhe djerse. Mbi kokën e saj ulërinin pulëbardhat dhe prej diku bërtiste një burrë.*

*- Ku është vëllai im që të më ndihmojë? Po motra ime, mamaja ime? Më ndihmo, Pasha, hajde të luajmë me top, fshihu në pyll që të*

*të gjej. Dasha, shiko se ç'ndodhi. Shiko si mbaruan të tëra. Nënë... Nënë... dua nënën time... Ku është familja ime që të më pyesë se si jam, të mos më lërë për asnjë çast vetëm dhe të heshtur, të më ndihmojë t'ia dal mbanë. Gjysh... ç'të bëj gjysh? Jam kaq e vetmuar, sa nuk di çfarë të bëj.*

Sot punëtori i portit nuk shkoi për të biseduar me shokët e tij, të tymoste cigare dhe të pinte kafënë bashkë me ta. Përkundrazi, kaloi rrugën dhe u ul në stol pranë Tatianës.

Ajo u çudit, por nuk tha asgjë. U mbështoll më fort me pallton e bardhë të infermieres që kishte veshur, ndreqi shaminë që kishte në kokë, shtrëngoi buzët dhe e hodhi vështrimin larg, në port.

Punëtori i foli në suedisht.

- Më quajnë Sven. Po ty?

Pas një heshtjeje të gjatë, ajo iu përgjigj:

- Tatiana. Nuk flas suedisht.

- Do një cigare? - e pyeti ai në anglisht.

- No, - iu përgjigj ajo, e sigurt se ai nuk do të dinte rusisht.

Sveni e pyeti nëse dëshironte t'i sillte një kafe ose diçka për të hedhur krahëve. Pa e vështruar, Tatiana iu përgjigj "jo" për të dyja.

Sveni mbeti për pak i heshtur. Mbi kokat e tyre piskatnin pulëbardhat.

- Dëshiron të hipësh në maunën time, apo s'është kështu? - foli më në fund ai. - Eja të të hip unë. E kapi nga supi, por Tatiana nuk lëvizi nga vendi. - Me sa duket ke lënë dikë pas, - i tha ai duke e ngritur me kujdes. - Shko merre!

Tatiana nuk lëvizi. - Mund të hipësh në maunë. Nuk ke pse ta bësh fshehurazi. Do të të lija të hipje që ditën e parë që erdhe këtu. Vetëm të ma kërkoje. Do të shkosh në Helsinki? Sigurisht që e di që nuk je finlandeze. Por je shtatzënë. Po ta kishe bërë që para dy muajsh, do të ishte shumë më e lehtë për ty. Vetë e vështirëson situatën. Por duhet të bësh ose përpara, ose mbrapa. Sa kohë do të qëndrosh këtu duke më vështruar nga pas?

Tatiana i nguli sytë në ujërat e Baltikut.

- Sa mendon se do të të duhej? - e pyeti ai.

- Nëse do ta dija, nuk do të qëndroja këtu.

- Mos qëndro më. Eja.

Ajo tundi kokën me inat.

- Ke qëndruar vetëm për një kohë të gjatë, - i tha punëtori. - Ku është burri yt? Ku është babai i fëmijës tënd?

- I vdekur... në Bashkimin Sovjetik.

- Ah, tani e kuptova, je nga Bashkimi Sovjetik. Dhe ti ia dole, në njëfarë mënyre, që të arratisesh. E po, atëherë, qëndro këtu. Qëndro në Suedi. Kërko strehim si refugjate. Dhjetëra njerëz vijnë këtu nëpërmjet Danimarkës.

Tatiana tundi kokën.

- Pas pak kohe do të lindësh, - i tha Sveni. - Bëj mbrapa ose ec përpara.

Tatiana kryqëzoi duart para barkut dhe e la vështrimin e saj të endej lirshëm. Punëtori e përkëdheli lehtë dhe u ngrit.

- Do të kthehesh në Bashkimin Sovjetik? Po përse?

Tatiana nuk iu përgjigj. Si t'i thoshte, se kishte lënë shpirtin atje?

- Ç'do të bëhet me ty nëse kthehesh mbrapsht?

- Sipas të gjitha mundësive, do të vdes, - pëshpëriti Tatiana.

- Po nëse bën përpara?

- Sipas të gjitha mundësive, do të jetoj.

Sveni rrahu shuplakat.

- Dhe ke vështirësi për të bërë zgjedhjen? Ec përpara!

- Mendon se nëse do të mundesha, nuk do ta bëja? Po si të jetoj kështu?

- Dhe, meqë nuk mund të shkosh as në ferr, as në parajsë, qëndro këtu në purgatorin e Stokholmit dhe më ndiq mua. Por pas pak kohe do të lindë fëmija yt. Ç'do të bësh atëherë? Do të qëndrosh bashkë me të këtu në stol? Këtë dëshiron?

Tatiana nuk foli.

*Kur e pa për herë të parë, qe ulur në një stol dhe po hante akulllore.*

- Ec përpara!

- Nuk kam kurajë.

- Ke. Duhet ta gjesh. I buzëqeshi. - Brenda teje është dimër, e di. Por këtu është verë. Ngricat do të shkrijnë.

Tatiana u ngrit me vështirësi. Në momentin që po largohej i tha në rusisht:

- Nuk bëhet më fjalë për ngricat, filozofi im i detit, por për turrën e druve.



Libri i parë

# AMERIKA E DYTË



*... Mbaje kokën lart  
Pas çdo dallge  
Ai është fryti yt  
Që detit dhe erës ia dhe.*

RUDYARD KIPLING



## KAPITULLI I

*Në spitalin e Morozovit, 13 mars 1943*

**N**ATË. Në një fshat të vogël peshkatarësh ku ishte vendosur shtabi i Ushtrisë së Kuqe për operacionet në Neva, në frontin e Leningradit, një i plagosur dergjej i shtrirë në spitalin ushtarak duke pritur vdekjen. Me duar të kryqëzuara në gjoks, qëndronte i shtrirë në krevatin e tij, derisa u fikën dritat dhe pavijoni i traumave të rënda ra në qetësi.

Pas pak do të vinin për ta marrë.

I plagosuri ishte i ri, njëzet e tre vjeç, por i dërrmuar nga lufta. Fytyrën e kishte shumë të zbehtë, si pasojë e muajve të tërë të kaluar shtrirë në krevatin e spitalit. Ishte i parruar dhe flokët e zinj i kishte të prerë shkurt. Sytë e tij, me ngjyrë karamелеje, vështronin si të përhumbur. Aleksandër Belovi kishte një pamje të zyrtë, por nuk ishte njeri i ashpër. Ngjante indiferent, por nuk ishte njeri i ftohtë.

Muaj më parë, gjatë betejës së Leningradit, Aleksandri kishte vrapuar për të ndihmuar shokun e tij të mirë, Anatoli Marazov, i cili dergjej me një plumb në qafë mbi akullin e lumit Neva. Bashkë me të kishte vrapuar dhe një mjek, po aq guximtar dhe i çartur. Një mjek i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, nga Bostoni, që quhej Methju Sejers, i cili ra në një gropë akulli dhe Aleksandri e nxori prej andej duke rrezikuar të humbiste jetën e tij, dhe e tërhoqi pas një automjeti të

blinduar për ta mbrojtur. Avionët gjermanë përpiqeshin të hidhnin në erë automjetin, por në vend të tij hodhën në erë Aleksandrin. Bombat e avionëve të *Luftwaffes* bënë që Aleksandri të shihte vdekjen me sy, ashtu si atëherë, në fillim të luftës në Luga, kur gjermanët mitralonin nga ajri arat e mbushura me gra dhe ushtarë.

Nga thonjtë e katër kalorësve të *Apokalipsit* e shpëtoi gruaja e tij, Tatiana. Tatiana, të cilës i kishte thënë: *Ik nga Leningradi dhe kthehu në Lazarevo*. Në Lazarevo, në atë vend të futur në zemër të Uraleve, në atë fshat të vogël peshkatarësh mes pyjeve në brigjet e lumit të vrullshëm Kama. Në Lazarevo, aty ku mund të ishte e sigurt, sikur edhe vetëm për pak kohë. Por ajo ishte si mjeku, e çartur. *Jo*, i kishte thënë. *Nuk do të shkoj*. Dhe, pa e ditur Aleksandri, ishte mobilizuar si infermiere në ushtri dhe kishte mbërritur në front. *Jo*, u kishte thënë edhe katër kalorësve të *Apokalipsit* duke shtrënguar grushtin e saj. *Nuk do t'ju lë ta merrni. Do të bëj gjithçka mundem që t'ju pengoj*.

Dhe e bëri. Me vetë gjakun e saj. Zbrazti arteriet e saj në damarët e Aleksandrit dhe e shpëtoi atë. Pastaj dëboi katër kalorësit.

Nëse tani Aleksandri ia detyronte jetën e tij Tatianës, doktor Sejeresi ia detyronte jetën e vet Aleksandrit. Dhe për t'ia shlyer borxhin, do të merrte me vete në Helsinki edhe Tatianën, nga ku do të niseshin për në Shtetet e Bashkuara. Hartuan një plan, një plan të mirë, dhe për dy muaj, për aq kohë sa ai e rimori veten, qëndroi i shtrirë në krevatin e tij në spital duke gdhendur në dru njerëz në miniaturë dhe djepa fëmijësh me thikën që i kishte sjellë Tatiana. Dhe, në imagjinatën e tij, e shihte veten së bashku me gruan duke shëtitur me makinë nëpër Amerikë. Duke dëgjuar muzikë nga radioja dhe duke kënduar, edhe pse jashtë mund të bënte vapë.

Krahët e shpresës e kishin ndihmuar për të mbijetuar. Por shpresa e tij zgjaste sa një çast dhe, megjithëse e dinte, përsëri preferonte të zhytej brenda saj. Ishte shpresa e një njeriu të rrethuar nga armiq, i cili vrapon për t'iu shpëtuar, para se të rimbushnin armët. Dëgjon pas vetes zërat e tyre, armët e tyre, por vazhdon të vrapojë duke shpresuar se do të shpëtojë. *Zhytu në shpresë, ose vdis në dëshpërim. Zhytu në lumin Kama*.

Sidoqoftë, fati i Aleksandrit ishte i përcaktuar. Nuk e dinte për sa kohë kishte qenë i tillë, por as nuk donte ta dinte.

Ishte përcaktuar që atëherë kur u largua nga dhoma e tij e vogël në Boston në dhjetor të vitit 1930. Që atëherë.

Aleksandri nuk mund të largohej nga Rusia. Por një fije e hollë shprese përkundej para syve të tij. Një rreze drite nga një qiri i venitur.

Që të largonte Tatianën nga Bashkimi Sovjetik, Aleksandër Belovi shtrëngoi dhëmbët dhe mbylli sytë. Shtrëngoi grushtet e tij dhe u tërhoq pas; e shtyu larg tij, e la të ikte.

Vetëm një gjë i kishte mbetur për të bërë në jetën e tij: të qëndronte gatitu dhe t'i përgjerohej mjekut që të mund t'i shpëtonte jetën gruas së tij. Për momentin nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të priste.

Kështu, që të mos e arrestonin me pizhamet e spitalit, Aleksandri i kërkoi infermieres së turnit të natës t'i sillte uniformën e tij më të mirë me gradën e majorit së bashku me kapelën. Ulur pranë krevatit, u rrua me thikën e tij ushtarake dhe me pak ujë, veshi uniformën dhe qëndroi duke pritur me duar të kryqëzuara. Kur të vinin për ta marrë, dhe këtë e dinte fare mirë që do të vinin, donte që t'i ndiqte me aq dinjitet sa do ta lejonin lakenjtë e NKVD-së. Kështu që priti duke dëgjuar gërhitjen e fortë të atij që ishte shtrirë në krevatin ngjitur.

Cilin realitet përjetonte sonte Aleksandri? Çfarë e përcaktonte vetëdijen e tij? Dhe më e rëndësishmja, çfarë do t'i ndodhte kur pas një ose dy orësh, gjithçka që Aleksandri kish menduar deri në atë moment do të vihej në diskutim? Kur shefi i policisë së fshehtë, gjenerali Mehlish do t'ia ngulte ato sytë e vegjël si rruaza dhe do ta pyeste: *Major, na thuaj se kush je?* - cila do të ishte përgjigjja e Aleksandrit?

Ishte ai burri i Tatianës?

Po.

- *Mos qaj, e dashura ime.*

- *Mos ik, edhe pak... Të lutem...*

- *Tanja, duhet të iki.*

*I kishte premtuar kolonelit Stepanov që do të kthehej të dielën në darkë, dhe nuk mund ta shkelte premtimin që i kish dhënë.*

- *Të lutem, mos ik!*

- *Tanja, do të marr përsëri leje, - i premtoi ai. - Do të vij përsëri sapo të mbarojë beteja e Leningradit. Por tani...*

- *Sura, të lutem... mos ik!*

- *Ti po më mban mua aq fort.*
  - *Jo, mos lëviz. Të lutem, vetëm...*
  - *Është pothuajse ora gjashtë, e dashur. Më duhet të shkoj.*
  - *Sura, i dashur, të lutem... mos ik!*
  - *Çfarë duhet të bëj?*
  - *Qëndro këtu, me mua. Përgjithmonë me mua.*
  - *Shëëët, Tanja, shëëët!*
- Pesë minuta më vonë, ai u turr drejt derës.*

*- Duhet të vrapoj, nuk mund të arrij në repart duke ecur. Nuk dua të eci natën. E ke ende pistoletën që të dhashë? Qëndro këtu. Mos më shih tani që do të iki nëpër korridor. Vetëm... qëndro këtu. E mbështolli me pallton e tij, e shtrëngoi pranë vetes dhe e puti në flokë, në buzë.*

*- Bëhu vajzë e mbarë, Tanja... Dhe mos më thuaj lamtumirë. Ajo e përshëndeti.*

*- Endiej, ti do të jesh kapiteni i zemrës sime, - dhe lotët i përshkuan faqet duke mos u ndalur nga dita e premte deri të shtunën.*

A ishte ai ushtar i Ushtrisë së Kuqe?

Po.

A ia kishte besuar ai jetën Dimitër Çernjenkos, atij demoni të maskuar si mik?

Përsëri po.

Por dikur, para se të ndodhnin të gjitha këto, Aleksandri kishte qenë një amerikan me mbiemrin Barrington. Fliste si amerikan. Qeshte si amerikan. Luante nëpër fusha lojëra amerikane, notonte si amerikan... dhe si amerikan i konsideronte të mirëqena të drejtat e jetës së tij. Kishte miq të cilët mendonte se do t'i kishte përjetë, dhe në Masaçusets kishte pyje të cilat i konsideronte si shtëpinë e tij, dhe një çantë të vogël ku mund të fshihte thesaret e tij të vogla - guaska dhe copa të gërryera xhami, të cilat i kishte gjetur në Nentaket Saund, qese karamesh, fije peri, një fotografi të shokut të tij, Tedit.

Dikur kishte patur një nënë, imazhi i i së cilës, me fytyrën e lyer me *mak-up* dhe përzhitur nga dielli, me sytë e mëdhenj, i qeshte ende në ëndrrat e tij.

Dhe kur hëna kaltëronte në qiellin e zi dhe yjet lëshonin dritë mbi të, Aleksandri kishte gjetur diçka e cila do të mund ta shpëtonte nga jeta e tij sovjetike.



Dikur.

Tani po i afrohej fundi Aleksandër Barringtonit. E, pra, nuk do të ikte qetësisht.

Mbërtheu në gjoks tri medaljet për trimëri të marra në luftë, si dhe dekoratën e *Urdhrit të Yllit të Kuq* që e kishte marrë kur kish kaluar me një tank luftarak mbi një liqen jo të ngrirë plotësisht, vuri kapelën, u ul në karrigen pranë shtratit dhe po priste.

Ai e dinte se si vinin tipat e NKVD-së për njerëz si ai. Donin të ishin sa më të kujdesshëm, t'i shihnin sa më pak njerëz. Vinin në mes të natës dhe afroheshin në mes të turmës në ndonjë stacion treni. Ose dërgonin fqinj për të të thënë nëse mund të shkoje për një moment në dhomën e tij. Vinin dhe uleshin pranë teje në mensë kur ishe duke ngrënë, ose të afroheshin kur po bëje pazar në ndonjë dyqan të madh plot me njerëz dhe të kërkonin t'i ndiqje pas në sektorin e porosive të veçanta. Qëndronin pranë teje në stolin e parkut ku kishe shkuar për të marrë pak ajër. Dhe ishin gjithnjë të sjellshëm, të qetë dhe të veshur mirë. Dikur, një grua e kishin arrestuar në mes të njerëzve në treg. E gjora, kish filluar të bërtiste dhe ish ngjitur në një shtyllë elektrike. Kish bërë aq rrëmujë, sa që njerëzit ishin grumbulluar përreth duke e parë. Hafijet e NKVD-së ishin detyruar ta linin të lirë për momentin. Dhe ajo, në vend që të largohej dhe të zhdukej në hapësirën e pafund, ish kthyer në shtëpi dhe kishte rënë për të fjetur që të vinte në vete. NKVD-ja e kish marrë në mes të natës.

*Për Aleksandrin kishin ardhur një pasdite kur po dilte nga shkolla. Kish qenë me një shok, kur dy burra iu afruan dhe i thanë se kishte harruar që kishte një takim me mësuesin e historisë dhe i kërkuan të kthehej pas që të fliste me të. Ai e kuptoi menjëherë, e nuhati gënjeshtren. Pa u lëkundur, e kapi shokun nga krahu dhe tundi kokën. Shoku i tij u largua, duke e kuptuar se ishte i tepërt. Aleksandri mbeti vetëm me dy burrat, duke menduar për mundësitë që kishte. Kur pa makinën e zezë që po afrohej nga kthesa, e kuptoi se nuk i mbetej shumë kohë. Pyeti veten nëse do ta qëllonin në mes të ditës, mes njerëzve rreth e rrotull. Mendoi se nuk do ta bënin një gjë të tillë, kështu që ia dha vrapit. Ishte vetëm shtatëmbëdhjetë ujeç, ndërsa ata tridhjetëujeçarë. Arriti t'u shpëtonte brenda pak*

*minutave, u fut në një rrugicë dhe doli te tregu afër kishës së Shën Nikollës. Pasi bleu një copë bukë, pati frikë të kthehej në shtëpi. Mendoi se do të shkonin ta kërkonin aty, kështu që e kaloi natën jashtë. Në mëngjes shkoi në shkollë, duke menduar se në klasë do të ishte i sigurt. Por erdhi vetë drejtori që i dha një shënim ku i thoshte të shkonte menjëherë në zyrën e tij. Sapo doli nga klasa, e rrëmbyen dhe e drejtuan pa thënë asnjë fjalë te makina e zezë.*

*Në Selinë Qendrore e rrahën dhe pastaj e çuan në burgun e Krestit, ku priste të vendosej fati i tij. Nuk kishte iluzione. Nuk ishte i fajshëm. Ishte një amerikan me emrin Aleksandër Barrington. Ky ishte krimi që kishte kryer.*

Por, gjithsesi, Aleksandri e dinte se NKVD-ja nuk do të bënte rrëmujë brenda në një pavijon spitali të traumave të rënda. E dinte se çfarë pretexti do të përdornin: do ta çonin në Volhov, ku do të gradohej nënkolonel. Qëllimi i tij ishte të mos arrinte në asnjë mënyrë në Volhov, ku e priste gjyqi dhe ekzekutimi. Këtu, në Morozovo, në mes të “aparatchikëve” pa përvojë kishte më shumë shanse për të mbijetuar.

Aleksandri e dinte se paragrafi 58 i “Kodit penal” sovjetik të vitit 1928 nuk e konsideronte as si të burgosur politik. Nëse e akuzonin për krime kundër shtetit, ishte thjesht një kriminel dhe do t’i jepnin dënimin respektiv. Nuk ishte e nevojshme të ishte amerikan, ose dikush që i kishte shpëtuar drejtësisë sovjetike. Nuk ishte nevoja të ishte spiun i huaj, madje as të kishte kryer ndonjë krim. Synimi për të tradhtuar kishte të njëjtin dënim me vetë tradhtinë. Qeveria sovjetike mburrej për superioritetin e saj ndaj kushtetutave perëndimore.

Çdo veprim ose synim që kishte si qëllim dobësimin e shtetit sovjetik ose të ushtrisë së tij, dënohej me vdekje. Dhe jo vetëm veprimi. Edhe mosveprimi ishte kundërrevolucionar.

Sa për Tatianën... Aleksandri e dinte mirë se në një mënyrë apo në një tjetër, Bashkimi Sovjetik do e merrte peng jetën e saj. Jetën e bashkëshortes së një spiuni amerikan. Para shumë kohësh, Aleksandri kishte planifikuar të arratisej në Amerikë, duke e lënë atë pas, si gruan e një dezertori të Ushtrisë së Kuqe. Ose ai do të vdiste në front, duke e lënë Tatianën të ve dhe të vetme në Bashkimin

Sovjetik. Ose *shoku* i tij, Dimitri, do ta denonconte te NKVD-ja, policia e fshehtë e Stalinit, ashtu siç kishte bërë, duke e lënë atë si gruan ruse të Aleksandër Barringtonit, spiunit amerikan dhe armikut të shtetit. Këto ishin mundësitë e pashpresa të Aleksandrit dhe vajzës së pafat që u bë gruaja e tij.

*Kur Mehlishi do të më pyesë se kush jam, a do të mundem ta përshëndes dhe t'i them se jam Aleksandër Barringtoni, apo nuk do ta kthej kokën pas?*

A mundej ta bënte? Mos ta kthente më kokën pas?

Nuk besonte se do ta bënte një gjë të tillë.

### *Mbërritja në Moskë, 1930*

Aleksandrit njëmbëdhjetëvjeçar i vinte për të vjellë.

- Ç'është kjo erë, mama? - pyeti ai, ndërkohë që të tre po hynin në një dhomë të vogël e të ftohtë, e cila nuk dukej fare e bukur kur babai ndezi dritën. Llamba shpërndante një dritë të verdhë e të zbehtë. Aleksandri, duke marrë frymë me gojë, la çantën e tij të shpinës përtokë dhe pyeti përsëri të ëmën. Por ajo as këtë herë nuk iu përgjigj. Hoqi kapelën dhe pallton, por kur e kuptoi se sa ftohtë bënte, e veshi përsëri dhe ndezi një cigare.

I ati vinte përçark në dhomë me hapa të mëdhenj duke prekur dollapin e vjetër, tavolinën prej druri dhe perdet gjithë pluhur.

- Nuk është dhe aq keq, - tha ai. - Për bukuri do të jemi këtu. Aleksandër, mamaja dhe unë do të qëndrojmë këtu. Ti ke dhomën tënde në krah. Eja të ta tregoj.

Aleksandri e kapi për dore dhe e ndoqi pas.

- Baba, por kjo era...

- Mos u shqetëso, - qeshi Haroldi. Mamaja jote do ta pastrojë. Le që nuk është ndonjë gjë e madhe. Thjesht... kur shumë njerëz jetojnë pranë njëri-tjetrit... I shtrëngoi dorën. - Është era e komunizmit, biri im!

Kishte rënë nata kur më në fund i çuan në hotelin ku do të qëndronin. Aleksandri kishte përshtypjen se ishte diku afër qendrës së qytetit, por nuk ishte i sigurt. Kishin arritur në Moskë në të gdhirë, pas një udhëtimi prej gjashtëmbëdhjetë orësh me tren që nga Praga. Dhe më

parë kishin udhëtuar njëzet orë të tjera me tren për të vajtur në Pragë nga Parisi, ku kishin qëndruar dy ditë duke pritur që të vinin dokumentet dhe leja e tyre. Aleksandrit i kishte pëlqyer Parisi. Të rriturit ishin të shqetësuar, por ai nuk u kushtonte rëndësi, sepse lexonte librin e tij të dashur, *Aventurat e Tom Sojerit*. Kur donte të shkëputej nga bisedat e të rriturve, hapte *Tom Sojerin* dhe menjëherë vinte në humor. Sigurisht që e ëma vazhdimisht përpiqej t'i shpjegonte se përse grindej me të atin, por ai uronte që të ndiqte shembullin e burrit të saj dhe të mos i thoshte asgjë. Nuk i duheshin shpjegime. Kishte nevojë për qetësi.

Por tani i duhej një shpjegim.

- Baba, ç'dreqin është kjo era e komunizmit?

- Aleksandër! - e qortoi i ati. - Si flet kështu? Ç'të mëson mamaja jote? As ajo dhe as unë nuk përdorim shprehje të tilla.

Aleksandrit nuk i pëlqente t'i kundërvihej të atit, por do të donte t'i kujtonte se, kur ai grindej me të ëmën, përdornin pikërisht këto shprehje - madje edhe më të këqija. Babai i tij kishte përshtypjen se, përderisa grindjet e tyre nuk kishin të bënin me Aleksandrin, ai nuk kishte pse t'i dëgjonte. A thua se prindërit e tij nuk ishin në dhomën ngjitur, apo në apartamentin ngjitur, ose ndonjëherë edhe përpara tij. Në Barrington, Aleksandri nuk i kishte dëgjuar asnjëherë. Dhoma e tyre e gjumit gjendej në anën tjetër të korridorit në katin e dytë. Midis tij dhe prindërve ndodheshin dyer dhe dhoma të tjera, kështu që nuk dëgjonte asnjëherë se ç'thoshin. Ashtu duhej.

- Baba, - këmbënguli përsëri ai, - të lutem, më thuaj, ç'është kjo erë?

- Vjen nga banjat, - iu përgjigj i ati disi me vështirësi.

Aleksandri i hodhi një sy dhomës së tij.

- E ku janë? - pyeti ai.

- Jashtë, në korridor, - buzëqeshi Haroldi. - Këtu pranë është, nuk do të të duhet të bësh dhe shumë rrugë natën.

Aleksandri e la çantën në dysHEME dhe hoqi pallton. Nuk i bënte përshtypje se sa ftohtë bënte, nuk kishte ndër mend të flinte me pallto.

- Baba, - tha duke marrë frymë me gojë dhe duke i ardhur për të vjellë, - nuk e di që unë nuk ngrihem kurrë natën për të shkuar në banjë? E kam gjumin të rëndë.

Kur Haroldi u largua, Aleksandri hodhi një sy nga krevati portativ i mbuluar me një batanije të hollë që gjendej në një cep dhe pastaj vështroi nga dritarja.

Kanata e dritares hapej për nga jashtë. Ishte dhjetor, termometri tregonte nën zero dhe ajri i ftohtë i Moskës i rrahu fytyrën. U përkul dhe vështroi poshtë në rrugë. Nga parvazi i dritares pa pesë burra të shtrirë. E la dritaren hapur. Ajri i ftohtë dhe i pastër do të largonte sadopak erën e rëndë.

Doli në korridor dhe u drejtua për nga banja, por nuk mundi të hynte brenda. Preferoi të kryente nevojat e tij në rrugë. Pastaj u kthye në dhomën e tij, u zhvesh dhe u shtri në shtrat. Ishte shumë i lodhur dhe gjumi e zuri menjëherë, por jo para se të pyeste veten nëse kishte dhe kapitalizmi erën e VET.

## KAPITULLI II

*Mbërritja në ishullin Elis, 1943*

**T**ATIANA u ngrit me vështirësi nga krevati dhe u afrua te dritarja. Ishte mëngjes. Pas pak infermierja do t'i sillte foshnjën që t'i jepte gji. Tërhoqi perdet e bardha dhe u përpoq të ngrinte xhamin, i cili nuk lëvizte, pasi ishte ngjitur pas kornizës së murit të lyer me të bardhë. Vuri të gjitha forcat dhe u përpoq përsëri. Ia arriti ta hapte dhe nxori kokën jashtë dritares. Mëngjesi ishte i ngrohtë dhe kishte aromën e ujit të kripur.

*Ujë i kripur.* Mori frymë thellë dhe buzëqeshi lehtë. I pëlqente shumë kjo aromë. Nuk ngjante me ato me të cilat ishte mësuar.

Pulëbardhat që vinin rrotull duke u çjerrë, i ishin bërë diçka e zakonshme.

Por pamja jo.

Porti i Nju-Jorkut ngjante si një pasqyrë e gjelbër në mjegullën e agimit. Në thellësi, matanë ujit, dalloi ca ndërtesa të larta dhe, në të djathtë, një statujë me një pishtar në dorën e djathtë të ngritur lart; dukej sikur të përshëndeste.

Tatiana u ul në parvaz dhe vështroi si e hipnotizuar ndërtesat matanë detit. Sa të larta që ishin! Sa të bukura dhe sa të shumta ishin! Me majë, katrore, ato gërvishtin qiejt duke lajmëruar

ekzistencën e vdekatarëve në kaltërsitë e pavdekshme. Vështronte zogjtë që fluturonin, ujërat e qeta, ndërtesat e pafundme, dhe vetë portin e qelqtë që hapej drejt Atlantikut.

Papritur megjulla u largua dhe dielli u shfaq dhe ra në sytë e saj, duke e detyruar që t'i mbyllte. Deti pranë portit, që shkëlqente si pasqyrë, filloi të valëzonte nga maunet, tragetet dhe anijet që lundronin mbi të duke fërshëllyer dhe duke bërë aq zhurmë të këndshme, saqë për momentin Tatiana mendoi ta mbyllte dritaren. Por nuk e bëri.

Gjithnjë kishte pasur dëshirë të shihte një oqean. Kishte parë Detin e Zi, Detin Baltik dhe shumë liqene - liqenin Ladoga më shumë seç duhej - por oqean nuk kishte parë kurrë në jetën e saj. Në anijen me të cilën arriti në SHBA qëndroi gjithë kohën e mbyllur në një kabinë. Tani shihte Atlantikun, oqeanin ku dikur Aleksandri bënte kanotazh, kur ishte fëmijë, duke vështruar fishekzjarrët e festimeve të 4 Korrikut, festës kombëtare të Amerikës. A s'ishte tani afër 4 Korriku? Ndoshta shkonte dhe ajo për të parë fishekzjarrët. Do të pyeste Brendën, infermierën e saj, që ngjante paksa me një lopë dhe që i jepte pa shumë dëshirë informacionet që i kërkonte, pa hequr nga fytyra maskën e kirurgjisë që vishte për të mos u infektuar nga Tatiana.

- Po, - tha Brenda. - Edhe këtë herë do të hedhin fishekzjarrë. 4 Korriku festohet pas dy ditësh. Nuk do të jetë si para luftës, por diçka do të bëhet. Po ty ç'të duhet? Nuk ke as një javë që ke ardhur në Amerikë dhe po pyet për fishekzjarrë? Duhet të kujdesesh për fëmijën tënd, se mos infektohet nga një sëmundje ngjitëse. Shëtite sot? Mjeku të ka thënë të dalësh çdo ditë dhe të marrësh ajër të pastër, ta mbash gojën të mbuluar, që të mos kollitesh mbi djalin dhe të mos e mbash hopa, se lodhesh. Vërtet, hëngre mëngjes? Brenda gjithnjë fliste shumë shpejt, i thoshte të gjitha menjëherë, sikur e bënte qëllimisht që të mos e kuptonte Tatiana.

Por lumi i fjalëve të saj nuk e pengonin Tatianën që të shijonte mëngjesin e saj që përbëhej nga vezë, proshutë, domate të pjekura dhe kafe me qumësht. E hante gjithnjë e ulur mbi krevat, ndërkohë që mendonte se çarçafët e pastër, dysheku i butë, jastëkët akoma më të butë dhe batanija e trashë prej leshi ishin kënaqësi me rëndësi jetike - ashtu si buka.

- Mund të ma sjellësh djalin tim tani? - e pyeti Brendën. - Duhet t'i jap gji. Gjijnjtë i ndiente të rëndë nga qumështi.

Brenda vajti dhe mbylli dritaren.

- Mos e hap më dritaren, - i tha ajo. - Do të të ftohet djali.

- Do të ftohet nga era e ngrohtë e verës? - e pyeti Tatiana duke qeshur.

- Po. Ka shumë lagështirë.

- Por ti sapo më the që të dal jashtë?

- Ajri jashtë është ndryshe, dhe ajri i dhomës është ndryshe...

- Djalit tim as që iu ngjit tuberkulozi prej meje, - u përgjigj Tatiana. - Më sill djalin tim, të lutem.

Pasi Brenda ia solli djalin dhe Tatiana e ushqeu, e hapi përsëri dritaren dhe ndenji në parvaz duke e mbajtur në prehër.

- Shiko, Antoni, - i pëshpëriti ajo në ruisht, në gjuhën e saj amtare të nënës. - A e sheh ujin? A s'është i bukur? Matanë portit ekziston një qytet i madh me njerëz, rrugë dhe parqe. Sapo të bëhem pak më mirë, do të hipim në ndonjë prej këtyre trageteve të zhurmsëm dhe do të shkojmë të shëtisim nëpër rrugët e Nju-Jorkut. A nuk do të jetë bukur? - dhe përkëdheli me duar fytyrën e djalit të saj. Pastaj e nguliti vështrimin përtej oqeanit. - Babait tënd do t'i pëlqente, - pëshpëriti ngadalë.



## KAPITULLI III

*Morozovo, 1943*

**M**ETHJU Sejers u shfaq pranë shtratit të Aleksandrit rreth orës një të natës.

- Këtu je ende? - e pyeti ai dhe ndaloi. - Ndoshta nuk vijnë për të të marrë.

Si amerikan i vërtetë që ishte, doktor Sejersi ishte një optimist i pandreqshëm.

Aleksandri tundi kokën dhe, të vetmen gjë që tha, ishte:

- E vendose dekoratën time të *Heroit të Bashkimit Sovjetik* në çantën e saj?

Mjeku pohoi me kokë.

- E fshehe siç të thashë?

- Sa më mirë që munda.

Sejersi nxori nga xhepi një shiringë, një ampulë dhe një shishe të vogël.

- Këto do të të nevojiten, - i tha ai.

- Më shumë do të më nevojitet pak duhan, - iu përgjigj Aleksandri.

- Ke ndonjë cigare?

Sejersi nxori paketën me cigare dhe ia zgjati atij.

- Bukur. Çakmak kam vetë.

Sejersi i tregoi ampulën e vogël me lëngun e tejdukshëm.

- Po të jap dhjetë gramë morfinë. Mos e merr të gjithën menjëherë.  
- Pse ta bëj këtë gjë? E kam ndërprerë morfinën para disa javësh.  
- Mund të të nevojitet përsëri. Ku i dihet... Të marrësh gjysmë... një gram e shumta. Dhjetë gramë janë të mjaftueshme për të vrarë dy vetë. Ke parë si përdoret?

- Po, - u përgjigj Aleksandri, ndërkohë që në mendje i shfaqej pamja e Tatianës duke iu afruar me një shiringë në dorë.

- Bukur. Vendi më i mirë për ta injektuar është pjesa sipër e barkut. Merr dhe pak sulfamid që mos të të infektohet përsëri plaga. Të solla dhe një shishe të vockël me acid fenik. Përdore për të dezinfektuar plagën nëse të mbarojnë ilaçet e tjera. Dhe një paketë me garza dhe fashë që ta ndërrosh përditë.

- Faleminderit, doktor.

Për një çast ra heshtja.

- I ke granatat?

Aleksandri tundi kokën.

- Një në çantë dhe një të futur në çizme.

- Po pistoletë?

Aleksandri përkëdheli këllëfin që mbante në rripin e pantallonave.

- Do të ta marrin.

- Sido që të jetë, unë vetë nuk kam për t'ua dorëzuar.

Mjeku i kapi dorën dhe ia shtrëngoi.

- E mban mend se ç'të thashë? - e pyeti Aleksandri. - Çfarëdo që të më ndodhë, ti do të marrësh këtë, - dhe i dha kapelën e tij, - do të më plotësosh një certifikatë vdekjeje dhe do t'i thuash se më pe të vdekur në liqen dhe se më hodhe brenda në një gropë në akull. U morëm vesh?

Mjeku tundi kokën.

- Do të bëj atë që duhet sa më mirë të mundem, - iu përgjigj. - Megjithëse... nuk dua ta bëj.

- E di.

Seriozë dhe të pikëlluar vështruan njëri-tjetrin.

- Major... ç'do të bëj nëse të gjej me të vërtetë të vdekur mbi akull?

- Do të plotësosh një certifikatë vdekjeje dhe do të më varrosësh në liqenin Ladoga. Pasi të kesh bërë kryqin, më parë. Aleksandri ndjeu ta pushtonte një rrëqethje e lehtë. - Mos harro t'i japësh kapelën time, - shtoi ai.

- Ai, Çernjenko, gjithë kohën vjen vërdallë makinës sime.  
- Nuk do të të lë të ikësh pa të, për këtë të garantoj. Duhet ta marrësh me vete.

- Nuk dua ta marr.

- Por, a dëshiron ta shpëtosh Tatianën? Nëse nuk vjen dhe ai, ajo nuk ka asnjë shpresë. Pra, nuk bëhet ndryshe. Thjesht bëj kujdes prej tij dhe mos e beso për asgjë.

- Ç'të bëj me të kur të arrijmë në Helsinki?

Aleksandri ia doli të buzëqeshte.

- Për këtë nuk mund të të jap ndonjë këshillë. Thjesht mos bëj asgjë që mund të të vërë në rrezik ty ose Tanjën.

- Sigurisht që jo.

- Duhet të tregohesh shumë i kujdesshëm, mospërfillës, i shkujdesur, trim. Nisuni sa më parë. I ke thënë Stepanovit që po largohesh?

Koloneli Mihail Stepanov ishte komandanti i Aleksandrit.

- I thashë se do të kthehem në Finlandë. Më kërkoi që ta çoj... gruan tënde, në Leningrad. Tha se do të ishte më mirë për të po të largohesh nga Morozovo.

Aleksandri pohoi me kokë.

- Kam folur me të. I kërkova t'i jepte leje Tatianës që të largohet me ty. Do ta marrësh me lejen e tij. Mirë, pra. Do të jetë më e lehtë për ju të largoheni nga baza.

- Stepanovi më tha se kur gradohet dikush e dërgojnë gjithnjë në Volhov. Mos ndoshta ma tha për të më mashtruar? Nuk mundem të dalloj më se çfarë është e vërtetë dhe çfarë gënjeshtër.

- Mirë se erdhe në botën time, - u përgjigj hidhur Aleksandri.

- E di Stepanovi se çfarë të pret?

- Ai më tregoi. Do të më kalojnë në bregun tjetër të liqenit, sepse këtu nuk kanë vend për ekzekutime. Por gruas sime nuk do t'ia thotë këto. Do t'i thotë se po shkoj për t'u graduar, ashtu siç i thashë edhe unë. Kur të hidhet në erë kamioni, NKVD-ja do të mbështesë versionin zyrtar. Nuk u pëlqen që të bëhet e ditur se arrestojnë oficerët e lartë. Do ta kenë shumë më të lehtë të thonë se kam vdekur.

- Por, dhe këtu, në Morozovo, kanë vend për ekzekutime, - tha Sejersi duke ulur zërin. - Nuk e dija që kishte vend për ekzekutime. Më kërkuan të shkoja për të vizituar dy ushtarë që po vdisnin nga

dizenteria. Ndodheshin në një dhomë të vogël në bodrumin e një shkollë të braktisur. Ishte njëfarë strehimi nga bombardimet, i ndarë në qeli të vogla. Mendova se ishte thjesht një karantinë. Sejersi ktheu vështrimin nga Aleksandri. - Nuk isha në gjendje t'i ndihmoja. Nuk e di pse nuk i lanë thjesht të vdisnin. Kur më thirrën, ishte tepër vonë.

- Të thirrën pikërisht në kohë. Në këtë mënyrë, ata vdiqën nën kujdesin e një mjeku të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Plotësisht e ligjshme.

- Ke frikë? - e pyeti Sejersi duke marrë frymë me vështirësi.

- Vetëm për Tatianën, - tha Aleksandri dhe i hodhi një shikim të shpejtë. - Po ti?

- Shumë.

Aleksandri tundi kokën në shenjë mirëkuptimi dhe u mbështet përsëri në karrigen e tij.

- Doktor, më thuaj diçka. A është shëruar mjaftueshëm plaga ime që të mund të kthehem në front?

- Jo.

- Do të hapet përsëri?

- Jo, por mund të infektohet përsëri. Mos harro të përdorësh sulfamidin.

- Nuk e harroj.

- Mos ki merak për Tanjën, - i tha mjeku dhe u bërë gati të ikte. - Do të jetë me mua. Nuk do ta lë për asnjë moment vetëm, derisa të arrijmë në Nju-Jork. Atje do të jetë e sigurt.

- Jepi nga pak çokolatë, - tha Aleksandri me mundim të madh.

- Thua se do ta ngushëllojë?

- Ti, jepja. Pesë herët e para do të kundërshtojë. Por herën e gjashtë do ta marrë.

Sejersi bëri të ikte. Para se të kalonte derën e pavijonit, u kthye dhe vështroi Aleksandrin. Për një moment vështrimet e tyre u kryqëzuan. Dhe pastaj Aleksandri e përshëndeti ushtarakisht.

### *Jeta në Moskë, 1930*

Kur arritën në Moskë, erdhën disa persona që i morën nga stacioni i trenit dhe i çuan në një restorant. Atje kaluan mbrëmjen, duke ngrënë

e duke pirë. Aleksandri dukej i entuziazmuar, ngaqë po rezultonte se babai i tij kishte të drejtë: jeta e tyre do të ishte e mirë. Ushqimi ishte i bollshëm; nuk ishte i keq. Vërtet që buka nuk ishte e freskët dhe, për çudi, edhe pula i dukej bajate. Gjalpi ishte gjysmë i shkrirë, uji i vakët, por çaji i zi ishte i ëmbël dhe i nxehtë. I ati e lejoi të pinte pak vodkë, ndërkohë që të gjithë ngrinin gotat e vogla prej kristali duke thirrur: “*Na zdorovye!*” (Për shëndetin tuaj!) E ëma e qortoi:

- Harold, u çmende? Mos i jep vodkë djalit! Pasi ajo vetë nuk pinte fare, vetëm sa lagte buzët. Por Aleksandri e piu me një frymë vodkën e tij - dhe e urreu menjëherë. Pastaj, për shumë kohë, i dogji fyti dhe e ëma e ngacmonte. Dhe, kur nuk i dogji më, e zuri gjumi në tavolinë. Ishte aq i lodhur...

Dhe pastaj hoteli.

Banjat e tij.

Hoteli ishte i pistë dhe i errët. Tapiceri të errëta, dysheme me pllaka të errëta, të cilat nuk formonin kënde të drejta me muret në cepat e dhomave. Ndoshta gabonte Aleksandri. Ndoshta arritjet e inxhinierisë revolucionare sovjetike nuk ishin dëgjuar ende në Amerikë. Ashtu si fliste i ati për shpresën ruse, Aleksandri nuk do të ndiente ndonjë çudi të madhe kur të mësonte se rrota nuk ishte zbuluar para Revolucionit të lavdishëm të Tetorit të 1917-s.

Të errëta dyshemetë, të errëta mbulesat e krevateve, të errët divanet, e zezë soba me dru në kuzhinë. Gjithçka e errët. Në dhomat ngjitur banonin tre vëllezër nga Gjeorgjia, me flokë të zinj kaçurrelë, me lëkurë zeshkane dhe sy të zinj. E pranuan dhe e përçafuan Aleksandrin si të afërm të tyre, megjithëse kishte lëkurë të bardhë dhe flokë të drejtë. I thërrisnin Sasha, si djalin të tyre të vogël, dhe e ulnin të hante kos të lëngshëm, që e quanin *kefir* - që Aleksandrit jo vetëm nuk i pëlqente, por i shkaktonte neveri.

Për fatin e tij të keq zbuloi se nuk i pëlqenin shumë gatimet ruse. Dhe, kryesisht, nuk mund të duronte ato pjata të mbushura me qepë dhe me uthull që i rreshtonin në tavolinë.

Përveç tre gjeorgjianëve, qiraxhinjtë e tjerë të katit të tyre nuk flisnin rusisht. Në katin e dytë të hotelit “Derzhava”, që në rusisht do të thotë “kala”, banonin tridhjetë vetë të tjerë që kishin ardhur në Bashkimin Sovjetik pak a shumë për të njëjtat arsye që kishin

ardhur edhe Barringtonët. Ishte një familje komunistësh nga Italia që i kishin zbuar nga Roma në fund të viteve '20. Bashkimi Sovjetik i kish pranuar menjëherë në gjirin e tij.

Ishte gjithashtu dhe një familje nga Belgjika dhe dy nga Anglia. Aleksandri i simpatizonte anglezët më shumë se të tjerët ngaqë flisnin anglisht. Por Haroldit nuk i pëlqente që Aleksandri vazhdonte të fliste anglisht. Dhe as anglezët nuk i simpatizonte. As italianët. Asnjërin nga ata që jetonin në katin e tyre. Harold Barringtoni donte që djali i tij të miqësohej me djem e vajza sovjetike. Donte që i biri të përvetësonte kulturën e Moskës dhe të mësonte rusisht. Dhe Aleksandri, duke dashur mbi të gjitha të kënaqte të atin, arriti t'i bënte.

Haroldi nuk e pati të vështirë për të gjetur punë në Moskë. Në Amerikë ku nuk ishte i detyruar të punonte ishte marrë me gjithçka, dhe megjithëse ishin të pakta ato që mund të bënte me të vërtetë mirë, shumë gjëra i bënte relativisht mirë. Edhe ato që nuk dinte t'i bënte, i mësonte shumë shpejt. Kështu, autoritetet e Moskës e vunë të punonte në shtypshkronjën "Pravda", të gazetës zyrtare sovjetike, dhjetë orë në ditë. Boja ia bënte aq pis gishtat, sa me zor i hiqej.

Mund të bënte dhe çati, por në Moskë nuk bëheshin shumë ndërtime. "Ende jo, - thoshte Haroldi, - por shpejt, shumë shpejt". Mund të punonte dhe në ndërtimin e rrugëve, por as vepra të tilla nuk bëheshin në Moskë - "ende jo, por shumë, shumë shpejt".

Mamaja e Aleksandrit ndiqte shembullin e të shoqit dhe mund të duronte gjithçka - përveç problemeve që kishte ai vend ku banonin. Aleksandri e përqeshte: "Baba, e aprovon faktin që mamaja ngeli me leckë në dorë që të largojë erën e proletariatit? Mama, babai nuk e aprovon, mos pastro më". Por Xheini fërkonte një orë të tërë vaskën e përbashkët para se të hynte për t'u larë. Në muajt e parë, pasi kthehej nga puna, pastronte çdo ditë banjën, ndërsa Aleksandri dhe i ati prisnin që t'u gatuante.

- Aleksandër, besoj se i lan duart sa herë që del nga ajo banjë...

- Mama, unë nuk jam fëmijë, - i tha Aleksandri. - Di t'i laj duart. Mori frymë thellë. - *Oh, l'eau de communisme*. Kaq i mprehtë, kaq i fortë, kaq...

- Mjaft! Edhe në shkollë laji duart; kudo që të shkosh.

- Po, mama.

- E di, - tha ajo duke ngritur supet, - sado erë e rëndë që vjen këtu, asgjë nuk krahasohet me kutërbimin që vjen nga korridori. E keni vënë re se ç'erë vjen në dhomën e Martës?

- Si të mos e vëmë re?

- Banon bashkë me dy djemtë në një dhomë. Kutërbimi është i tmerrshëm.

- Nuk e dija që Marta kishte dy djem.

- Po. Muajin e kaluar erdhën nga Leningradi që ta vizitonin, dhe mbetën këtu.

Aleksandri shtrembëroi fytyrën.

- Do të thuash se prej tyre qelbet erë i gjithë vendi? - pyeti ai.

- Jo ata, - iu përgjigj duke nënqeshur Xheini, - prostitutat që sjellin nga stacioni i trenit. - Një natë po, një jo sjellin nga një të re. Dhe ato qelben në erë.

- Nënë, mos i gjyko kështu njerëzit. Nuk kanë mundësi të gjithë që të blejnë parfum "Chanel" duke kaluar nga Parisi. Vërtet, pse nuk u jep pak nga parfumi yt atyre prostitutave që të bëjnë një pastrim "francez"?

I pëlqeu shakaja që bëri dhe filloi të qeshte.

- Do t'i tregoj babait tënd!

Babai, që ishte përpara tyre, tha:

- Nëse nuk do të flisje për prostituta para djalit tonë njëmbëdhjetëvjeçar, mund të zgjidhej problemi.

- Aleksandër, gëzuar Krishtlindjet! - ndërroi temë Xheini dhe buzëqeshi me melankoli. - Babait nuk i pëlqen të kujtohem për këto tradita të pakuptimta, por...

- Nuk është se nuk më pëlqen, - e ndërpreu Haroldi. - Dua thjesht t'i vendosim në përmasat e tyre të vërteta dhe të kuptojmë se janë të kaluara, të harruara dhe të panevojshme.

- Edhe unë jam plotësisht dakord me ty, - vazhdoi qetësisht Xheini. - Por herë pas here ndien një si peshë në kraharor, apo jo?

- Veçanërisht në disa ditë si kjo e sotmja, - foli Aleksandri.

- Po. Epo, mirë. Hëngrëm mirë sonte, dhuratën do ta marrësh për Vit të Ri, ashtu si gjithë djemtë e tjerë në Bashkimin Sovjetik... Sigurisht, jo nga Santa Klaus. Nuk beson më te Santa Klaus, apo jo, biri im?

- Jo, nënë, - u përgjigj ngadalë Aleksandri pa e vështruar.

- Që kur?

- Që në këtë moment, - u përgjigj djali dhe u ngrit për të hequr pjatën e tij nga tavolina.

Xhein Barringtoni gjeti punë si bibliotekare në bibliotekën universitare, por pas disa muajsh e transferuan në sektorin e enciklopedive, pastaj te hartat, dhe në fund fare e bënë kameriere në kafenenë e universitetit. Çdo darkë, pasi pastronte më parë banjat, përgatiste një darkë me gatim rus për familjen e saj, duke u ankuar se nuk gjente në treg mozarellë, vaj ulliri dhe borzilok të freskët për të gatuar makaronat - por Haroldi me Aleksandrin nuk i kushtonin rëndësi. Hanin lakër të zier, salsiçe, patate, kërpudha dhe bukë të zezë me kripë; Haroldi i kërkoi Xheinit që të mësonte të gatuar borsh me mish viçi, ashtu si dinte çdo grua tradicionale ruse.

Aleksandri kish rënë në gjumë të thellë, kur papritur e zgjuan të thirrurat e nënës së tij. U ngrit me hezitim dhe doli në korridor. E ëma, e veshur vetëm me këmbë të bardhë të natës, shante një prej djemve të Martës që qëndronte i përkulur në fund të korridorit pa ia hedhur sytë. Xheini mbante në duar një tenxhere. Haroldi nuk dukej gjëkund.

- Ç'po ndodh? - e pyeti Aleksandri.

- Vajta në banjë dhe pastaj thashë të pija pak ujë. Dhe ç'gjeta në kuzhinë, mund të më thuash, të lutem? Gjeta këtë shtazë, këtë kafshë të qelbur, me atë dorën e tij gjigande të futur brenda në borshin që kisha gatuar, duke ngjyer dhe duke ngrënë mishin! Mishin tim! Borshin tim! Brenda në tenxhere, me duar! Pisanjosi! U kthye përsëri nga djali i Martës. - I qelbur dhe pisanjos je! Nuk tregon aspak respekt për pronën e të tjerëve!

Aleksandri qëndronte i zhveshur në korridor duke dëgjuar nënën e tij të bërtiste dhe për disa minuta të tjera, derisa e pa të kthehej dhe të derdhte me një kënaqësi sadiste tenxheren në lavaman.

- As nuk mund ta mendoj që mund të ha pas futjes së duarve të atij kafshe, - tha ajo.

Aleksandri u kthye në krevatin e tij.

Mëngjesin tjetër Xheini fliste përsëri për këtë ngjarje. Edhe pasdite, kur u kthye Aleksandri nga shkolla. Edhe kur ishin duke ngrënë darkë - jo borsh të shijshëm, por një supë të pazier mirë dhe



pa mish, e cila nuk i pëlqeu fare. Aleksandri kuptoi se i pëlqente të hante mish. Mishi e ngopte si asgjë tjetër. Ishte në moshën që hidhte shtat dhe duhej të ushqejej mirë: pulë, mish viçi, mish derri. Peshk, nëse kishte. Një drekë vetëm me zarzavate nuk i pëlqente fare.

Pasi dëgjoji të gjitha ato që thoshte Xheini, Haroldi i tha:

- Qetësohu, tani... mos bëj kështu.

- Si të mos bëj kështu? Të të pyes për diçka. Mendon se ai qelbësira i lau duart pasi solli në dhomë atë prostitutën nga stacioni i trenit, e cila ishte e pisët që më parë?

- Po supën e derdhe. Pse bën kështu? - i tha Haroldi.

Aleksandri u përpoq të rrinte serioz. Shkëmbeu një vështrim me të atin. Meqë ai nuk foli, Aleksandri u kollit dhe tha:

- Mama, duhet të theksoj se sjellja jote nuk është dhe aq socialiste. Djali i Martës ka çdo të drejtë mbi supën tënde. Ashtu siç ke dhe ti çdo të drejtë mbi prostitutën e tij. Sigurisht që ti nuk e do, por nëse do ta doje, edhe nëse do të ishte e tij, që nuk është, dhe këtu qëndron i gjithë problemi, do të kishe çdo të drejtë mbi të. Ashtu siç ke çdo të drejtë mbi gjalpin e tij. Do pak nga gjalpi i tij? Po shkoj të ta sjell.

Haroldi dhe Xheini e vështruan. Dukej qartë nuk u kishte pëlqyer aspak.

- Aleksandër, u çmende? Përse të dëshiroj diçka që i takon atij njeriu?

- Këtë po përpiqem të të shpjegoj, nënë. Nuk ka asgjë. As ty nuk të takon gjë. Ajo që është e tij, është edhe e jotja, dhe anasjelltas. Kishte çdo të drejtë për të provuar supën tënde. Këtë më mësoni prej kaq kohësh. Këtë më mësojnë dhe në shkollën moskovite. Kështu është më mirë për të gjithë ne. Prandaj jetojmë kështu. Që të kemi mirëqenie nëpërmjet mirëqenies së tjetrit. Që të shijojmë frytet e arritjeve të të tjerëve. Personalisht, nuk kuptoj pse bëre kaq pak borsh. E di që Nastia, në fund të korridorit, ka pa ngrënë që vjet borsh me mish?

Aleksandri pushoi dhe vështroi gjithë qejf prindërit e tij.

- A s'më thua, ç'të gjeti, për atë Zot? - i tha e ëma.

Aleksandri nuk iu përgjigj. Mbaroi së ngrëni zarzavatet dhe qepët, dhe u kthye nga i ati.

- Kur është mbledhja tjetër e Partisë? Mezi po pres që të vij.

- Të të them diçka, bir? - ndërhyri Xheini. - Më duket se nuk do të shkosh më në mbledhjet e Partisë.

- Përkundrazi, - tha Haroldi duke përkëdhelur flokët e të birit, - unë mendoj se i duhet të shkojë.

Aleksandri buzëqeshi.

Në Moskë kishin mbërritur në dimër. Pas tre muajve të parë kuptuan se, që të gjenin gjërat që u nevojiteshin, si miell i bardhë ose llamba elektrike, duhet të shkonin në treg të zi, tek ata tregtarët që vinin vërdallë nëpër stacionet hekurudhore dhe nxirrnin nga xhepat e tyre proshutë dhe fruta. Çmimet e produkteve që ata tregtonin ishin të larta dhe Haroldi refuzonte të paguante. Hante racionet e vogla të bukës së zezë që u jepnin me tollon, hante borsh pa mish dhe patate pa gjalpë, por me shumë vaj liri - që deri në atë moment e dinin që përdorej vetëm për të prodhuar bojëra dhe për të lustruar drurin.

- Nuk kemi të holla për të blerë në treg të zi. Mund ta kalojmë edhe një dimër pa fruta. Vitin që vjen do të ketë me bollëk. Lëre që nuk kemi pará. Ku do të gjejmë pará për të paguar këta privatë?

Xheini nuk përgjigjej, ndërsa Aleksandri ngrinte supet pasi nuk dinte. Por kur Haroldi shkante për të fjetur, Xheini shkante në dhomën e të birit dhe i pëshpëriste të shkante në mëngjes dhe të blinte portokaj, që të mos sëmurej me skorbut, dhe proshutë, që të mos sëmurej me distrofi, ose pak nga qumështi i freskët që ishte aq i rrallë.

- Më dëgjon, Aleksandër? Po të vë dollarë amerikanë në xhepin e brendshëm të çantës. Dakord?

- Dakord, nënë. Po ku i gjete dollarët amerikanë?

- S'ka ç'të duhet, bir! Mora me vete ca, për të mirë a për të keq. Në errësirën e dhomës u përkul mbi të dhe e puthi në ballë. - Gjërat nuk rregullohen nga njëra ditë në tjetrën. E di se ç'ndodh në Amerikën tonë? Ka shpërthyer një krizë e thellë ekonomike. Varfëri, papunësi, gjërat janë vështirësuar gjithandej. Janë kohë të këqija. Por ne jetojmë sipas parimeve tona. Po ndërtojmë një shtet të ri që nuk bazohet në shfrytëzim, por mbi parime shoqërore dhe përfitim reciprok.

- Me disa dollarë amerikanë ekstra? - pyeste duke pëshpëritur Aleksandri.

- Me disa dollarë amerikanë ekstra, - binte dakord e ëma dhe e përqafonte. - Por, mos ia thuaj babait. Do të mërzhitet shumë. Do të kujtojë se e kam tradhtuar.

- Nuk do t'ia them.

Dimrin pasardhës Aleksandri ishte dymbëdhjetë vjeç, por përsëri nuk kishte fruta të freskëta në Moskë. I ftohti ishte gjithnjë i hidhur, dhe i vetmi ndryshim midis dimrit të vitit 1931 dhe dimrit të vitit 1930 ishte që tregtarët e tregut të zi ishin zhdukur nga stacionet hekurudhore. I kishin dërguar për dhjetë vjet në Siberi, për sjellje kundërrevolucionare dhe antiproletare.

## KAPITULLI IV

*Jeta në ishullin Elis, 1943*

**P**ËR aq kohë sa Tatiana ishte e detyruar të qëndronte në krevat për t'u bërë më mirë, përpiquej të lexonte që të përmirësonte anglishten. Në bibliotekën vogël, por të pasur të Elisit, gjeti shumë libra të dhuruara nga mjekë, infermiere dhe bamirës. Madje gjeti edhe libra në rusisht: Majakovskin, Gorkin, Tolstoin. Tatiana lexonte në dhomën e saj, por nuk mund të përqendrohej. Mendja i fluturonte në lumenj me akuj e gjak, bombardime, avionë, mortaja, gropa në akull, thurje e qëndisje, tek e ëma e shtrirë në divan duke mbajtur në duar çarçafin e qepur për trupin e saj të pajetë, te motra e saj e ngrirë dhe e uritur mbi një sërë trupash të pajetë, te vëllai i saj që ishte zhdukur, te trena që hidheshin në erë, te babai i saj i djegur, te gjyshi i saj me mushkëritë e infektuara dhe te gjyshja që vdiq nga pikëllimi. Kamuflazh i bardhë, pellgje gjaku, flokë të zinj të lagur, një kapele oficeri e hedhur mënjanë, mbi akull, imazhe aq reale, sa që detyrohej të shkonte në banjën e përbashkët për të vjellë dhe pastaj shtrihej përsëri duke u përpjekur të përvetësonte më së miri anglishten e saj, thjesht të merrej me diçka për të larguar mendjen dhe për të mos e lejuar që të shpërndahej andej-këndej, në atë boshllëk të zi që vinte erë frikë dhe tmerr, dhe e bënte të dridhej e tëra.

Merrte Antonin e vogël nga djepi dhe e shrinte mbi gjoksin e saj, që të ndiente pak ngrohtësi njerëzore, pak ngushëllim. Por sado aromë të mirë që mbante vogëlushi i saj, sado të buta që të ishin flokët e tij të zinj e të mëndafshhtë mbi buzët e saj, mendja nuk ndalonte së bredhuri larg. Nëse diçka...

Ndërkaq i pëlqente t'i merrte erë. Kur bënte vapë, i pëlqente ta zhvishte dhe t'i merrte erë trupit të tij të rrumbullakët. I pëlqente aroma e flokëve, e qafës dhe e frymës së tij. I pëlqente ta kthente mbrapsht, t'i përkëdhelte supet dhe prapanicat; t'i merrte erë zverkut të tij ashtu siç flinte i lumtur.

- Nuk zgjohet asnjëherë ky fëmijë? - e pyeti një ditë doktor Eduard Lادلou.

- Thua se është luan, - iu përgjigj ngadalë Tatiana me anglishten e saj. - Fle gjithë ditën dhe zgjohet natën.

Eduardi buzëqeshi.

- Po shërohesh, - i tha. - Fillove të bësh shaka.

Ajo ia ktheu menjëherë buzëqeshjen. Doktor Lادلou ishte një burrë i dobët, me lëvizje të gëzuara dhe të lehta. Nuk e ngrinte zërin, nuk bënte gjeste të papërshtatshme. Vështrimi i tij, zëri i tij, lëvizjet e tij, dhuronin njëfarë ngushëllimi. Ishte mjek shumë i mirë. Të sëmuret qetësoheshin kur gjendeshin pranë tij. Tatiana mendonte se ishte afërsisht tridhjetë e pesë vjeç dhe mendonte se dikur kishte qenë ushtarak, pasi e mbante trupin gjithnjë drejt. Ndiente se me vështrimin e tij serioz mund të kishte më shumë besim tek ai.

Doktor Lادلou kishte pritur fëmijën e saj kur arriti në portin e Nju-Jorkut, dhe tani vinte çdo ditë që të shihte se si po shkonte shëndeti i saj, megjithëse, sipas Brendës, Lادلou vinte në Elis vetëm dy herë në javë.

Eduardi vështroi orën e tij dhe tha:

- Po afrohet ora për të ngrënë drekë. Nëse dëshiron, si thua, dalim që të ecësh pak dhe të hamë në mensë? Vish robdëshambrin dhe shkojmë.

- Jo, jo, - u përgjigj Tatiana papritur. Nuk donte të largohej nga dhoma e saj.

- Eja.

- Por unë jam me tuberkuloz.

- Vendos maskën tënde, - i tha ai duke e ngritur nga supet.

Duke hezituar, pa pasur dëshirë, e ndoqi pas. U ulën për të ngrënë në një prej tavolinave të stërgjiata të sallës së madhe me dritare të larta.

- Ushqimi nuk është dhe aq i mirë, - i tha Eduardi dhe vështroi pjatën e tij. - Mua më japin dhe mish. Merr pak, - i tha ai duke e ndarë në dysh pjesën e tij, dhe i zgjati gjysmën.

- Të faleminderit, por shiko sa shumë ushqim kam, - i tha Tatiana. - Kam bukë të bardhë, margarinë, patate dhe oriz me misër. Janë kaq shumë!

*Qëndron në dhomën e errët. Përpara ka një pjatë me një copë bukë bajate të zezë sa një pako letrash bixhozi. Brumi i bukës është gatuar me tallash dhe copa kartoni. Merr pirunin dhe thikën dhe e ndan në katërsh. Fut në gojë një copë, e bluan mirë dhe e kalon me vështirësi në grykë. Pastaj ha dhe copën tjetër, dhe tjetrën, dhe pastaj... të fundit. Atë e bluan akoma dhe më shumë. E di që kur të mbarojë nuk do të ketë më asgjë tjetër për të ngrënë deri në mëngjes. Do të donte të kishte forcë të mjaftueshme për të vënë mënjanë gjysmën e bukës deri në drekë, por nuk e kishte, nuk duronte dot. Ngre vështrimin drejt motrës së saj, Dashës, e cila po e vështron. Pjata e saj ka kohë që është bosh.*

- Sa mirë do të ishte po të vinte përsëri Aleksandri, - tha Dasha. - Mund të na sillte diçka për të ngrënë.

U rrëqeth. Patatja i iku nga piruni dhe ra përtokë. U përkul, e mori, i fryu dhe e hëngri pa thënë asnjë fjalë.

Eduardi e vështroi, piruni i tij me mish gjendej midis pjatës dhe gojës së tij.

- Ka sheqer, çaj, kafe dhe qumësht të kondensuar, - vazhdoi Tatiana me zërin që i dridhej. - Ka dhe mollë dhe portokaj.

- Ka shumë pak pulë, pothuajse aspak mish viçi, pak qumësht dhe aspak gjalpë, - u përgjigj Eduardi. - Të plagosurit kanë nevojë për gjithë gjalpin tonë që të shërohen, dhe ne s'kemi fare. Ti e di që po të kishin gjalpë, do të shëroheshin më shpejt, por nuk kanë.

- Ndoshta nuk duan të shërohen shpejt. Ndoshta u pëlqen këtu, - tha Tatiana duke vënë re se Eduardi po e studionte përsëri me vështrimin e tij. Iu kujtua diçka. - Eduard, the që ka qumësht?

- Të freskët, po. Jo shumë, natyrisht.

- Më sill qumësht, një enë të madhe dhe një lugë druri të gjatë.

Sill dhjetë... njëzet litra qumësht. Sa më shumë, aq më mirë. Nesër do të hamë gjalpë.

- Ç'lidhje ka qumështi me gjalpin? - e pyeti Eduardi.

Ishte radha e Tatianës që ta studionte me vështirimin e saj. Ai buzëqeshi.

- Mjek jam, jo bujk. Hajde, ha. Ke nevojë për fuqi. Përfundimisht ke të drejtë. Me gjithë mungesat, ka ushqim me bollëk.

## KAPITULLI V

*Morozovo, 1943*

**E**RDHËN për ta marrë pas disa orësh, në mes të natës. Aleksandrin e kishte zënë gjumi në karrige. E tundën që ta zgjonin. Sapo hapi sytë pa katër burra të veshur me kostume, të cilët i bënin shenjë të ngrihej.

U ngrit me lëvizje të ngadalta.

- Do të shkosh në Volhov për t'u dekoruar. Nxito! Nuk kemi kohë për të humbur. Duhet ta kalojmë liqenin pa gdhirë. Gjermanët po e bombardojnë vazhdimisht Ladogën. Verdhacuku që i fliste me zë të ulët, me sa dukej ishte kryetari i grupit. Tre të tjerët nuk folën fare.

Aleksandri mori çantën e tij të shpinës.

- Lëre këtu atë, - i tha verdhacuku.

- Jam ushtar, e marr gjithmonë me vete çantën time. Pra, nëse nuk të prish punë, do ta marr.

- E ke me vete pistoletën tënde?

- Sigurisht.

- Mund të na e japësh?

Aleksandri bëri një hap në drejtim të tyre. Ishte një kokë më i gjatë nga të tërë. Dukeshin si banditë, të mbështjellë me ato xhaketat e tyre ngjyrë gri, me spaletat e vogla blu të NKVD-së të Komisariatit të Popullit për Punët e Brendshme.



- Pa prit ta marr vesh se çfarë po më kërkon, - tha qetë, por me një zë të prerë. - Po më kërkon të dorëzohet armën time?

- Po, për të të lehtësuar, - belbëzoi verdhacuku. - Je i plagosur dhe do ta kesh të vështirë t'i mbash të gjitha gjërat e tua...

- Nuk po marr gjithë gjërat e mia, vetëm disa sende personale. Hajde, shkojmë, - ngriti zërin Aleksandri duke i shtyrë të gjithë anash. - Hajdeni, shokë, po humbasim kohë. Ata donin ta bënin punën e tyre në qetësi. Nuk donin që t'i dëgjonin infermieret e përgjumura dhe të plagosurit gjysmë të fjetur. Policia donte të jepte përshtypjen se gjithçka ishte në rregull. Një ushtar i plagosur po shoqërohej në mes të natës përtej liqenit për t'u dekoruar. Diçka krejt e zakonshme. Kështu që nuk ia morën armën. Kur të dilnin nga spitali do të vendosnin se çfarë do të bënin.

Duke ikur, Aleksandri vuri re se dy shtretërit pranë tij ishin boshatisur. I plagosuri me probleme në frymëmarrje dhe tjetri, gjithashtu, kishin ikur. Tundi kokën dhe pyeti me një ironi të dukshme:

- Edhe këta për t'u dekoruar kanë vajtur?

- Lëri pyetjet dhe vazhdo përpara. Shpejt!

Aleksandri e kishte të vështirë të ecte shpejt, por përpiquej.

Duke përshtuar korridorin, pyeti veten se ku do të ishte duke fjetur Tatiana. Mos ndoshta pas ndonjëres prej atyre dyerve? Kaq pranë tij? Mori frymë thellë, thua se do t'i merrte erë.

Pas ndërtesës priste një makinë e blinduar, parkuar pranë xhipit të doktor Sejersit me shenjën e Kryqit të Kuq, që dallohej qartë në mes të errësirës. Tek i afroreshin makinës, një siluetë u shfaq pas hijeve. Ishte Dimitri. Dorën e vënë në allçi e mbante me një lidhëse të kaluar në qafë dhe hundën e kishte aq të ënjtur, sa i dukej si një gungë.

Qëndroi për një moment pa folur. Dhe pastaj tha:

- Për ku kështu, major Belov?

Kur tha Belov, sikur e theksoi në mënyrë të çuditshme këtë fjalë. U dëgjua si *Belofffff*.

- Dimitër, mos m'u afro, - iu përgjigj Aleksandri.

Ai bëri menjëherë një hap prapa dhe pastaj buzëqeshi me ngadalë.

- Tani nuk mund të më ngacmoh më, Aleksandër.

- As ti mua.

- Oh, unë mundem, më beso, - tha Dimitri dhe i tundi gishtin në mënyrë kërcënuese, ndërsa hafijet e NKVD-së e shtynë Aleksandrin brenda në makinë.

Aleksandri ktheu kokën, drejtoi supet dhe, teksa futej në makinë pa parë fare në drejtim të Dimitrit, tha me zë të lartë dhe të qartë:

- Ik, pirdhu!

- Futu brenda dhe mbylle gojën, - i tha njëri nga hafijet e NKVD-së Aleksandrit. Më pas iu drejtua Dimitrit: - Kthehu në pavijonin tënd, të ka kaluar ora. Çfarë pune ke këtu jashtë?

Në pjesën e pasme të makinës Aleksandri pa dy të plagosurit e tjerë që ishin zhdukur nga pavijoni dhe po qëndronin aty duke u dridhur. Nuk e priste që të ishin dhe dy të tjerë bashkë me të, dy ushtarë të tjerë të Ushtrisë së Kuqe. Kishte menduar se nuk ishte nevoja të sakrifkoheshin dhe të tjerë, përveç atij vetë dhe hafijeve të NKVD-së. Po tani?

Njëri prej tyre bëri t'i merrte çantën. Aleksandri e tërhoqi, por tjetri nuk e lëshoi.

- Duket se të rëndon pak si tepër, - tha ai duke e tërhequr. - Po e marr unë dhe do të ta jap kur të arrijmë.

- Jo, - tha Aleksandri duke tundur kokën, - e mbaj vetë.

- Belov...

- Rreshter! - ngriti zërin Aleksandri. - Po i drejtohesh një oficeri. Për ty jam major Belovi. Mos i prek sendet e mia personale! Tani do të nisemi. Kemi rrugë të gjatë përpara, - qeshi me veten dhe u kthye.

Shpina nuk i dhembte aq shumë sa e kishte imagjinuar. Mundej të ecte, të hidhej, të fliste, të përkulej dhe të ulej përtokë. Por dobësia që ndiente e mërziste, gjithsesi.

Motori i makinës filloi të xhironte. Ndërkohë vuri re se po largoheshin nga spitali, nga Morozovo, nga Tatiana. Aleksandri mori frymë thellë dhe u kthye nga dy burrat që qëndronin përballë tij.

- Kush dreqin jeni ju? - i pyeti ai. Fjalët ishin të ashpra, por toni i zërit të tij ishte i qetë. Në mes të errësirës nuk mundej t'i dallonte mirë tiparet e tyre. Më i shkurtri kishte syze, ndërsa tjetri qëndronte i mbështjellë me kapotën e tij dhe kokën të lidhur me fashë. Vetëm hunda, goja dhe sytë e tij të shndritshëm dhe vigjilentë dalloheshin edhe në errësirë, edhe në mes të natës. "Të shndritshëm" - ndoshta nuk është fjala e duhur. Të djallëzuar.

Nuk mund të thuhej e njëjta gjë në sytë e burrit tjetër. Ato ngjanin si të mpira.

- Kush jeni ju? - pyeti përsëri Aleksandri.

- Toger Nikolai Uspenski. Ky është tetari Boris Maikov. U plagosëm në aksionin “Shkëndija” më 15 janar, në rrethinat e Volhovit. Ishim në një tendë kur...

- Mjaft, - tha Aleksandri, që donte t’u shtrëngonte dorën për t’u përpjekur të kuptonte prej çfarë lënde ishin gatuar. Uspenski ia shtrëngoi dorën normalisht, pa frikë, miqësisht. Maikovi i dha dorën e majtë që i dridhej.

Aleksandri mbështeti shpatullat në muret e makinës dhe kapi granatën që kishte fshehur në çizmen e tij ushtarake. Dëgjonte frymëmarrjen e Uspenskit që ngjante si gërhitje. Ai ishte ushtari që krevatet e tyre i ndante një paravento. Ishte ai që kishte vetëm një mushkëri, dhe as dëgjonte, as fliste. Po ja që tani e kishte përpara syve të ulur, duke folur, duke dëgjuar dhe duke marrë frymë pa ndihmën e maskës me oksigjen.

- Më dëgjoni mirë që të dy, - tha Aleksandri. - Mblidhni forcat, do t’ju duhen.

- Që të marrim dekoratën? - pyeti me dyshim Maikovi.

- Do të dekorohesh pas vdekjes, nëse nuk e mbledh veten dhe nëse nuk rresht së dridhuri, - iu përgjigj Aleksandri.

- Nga e kupton ti që po dridhem?

- Dëgjoj çizmet e tua që po kërcasin mbi njëra-tjetrën, - tha Aleksandri. - Mos bëj zhurmë, ushtar.

Maikovi u kthye nga Uspenski.

- Unë ta thashë, toger, kjo nuk është aspak normale të na zgjojnë kështu në mes të natës...

- Dhe unë të thashë ta mbyllësh gojën, - tha Aleksandri.

Nga dritarja e vogël në ndarjen e kabinës së shoferit hynte një dritë blu e zbehtë.

- Toger, - i tha Aleksandri Uspenskit, - mund të ngrihesh? Dua të qëndrosh para dritares.

- Herën e fundit që ma tha këtë dikush, ishte një shoku im që donte të merrte pak kokainë në kazermë, - tha Uspenski duke buzëqeshur.

- Epo, të jesh i sigurt se këtu nuk do të marrë njeri kokainë, - tha Aleksandri. - Ngrihu!

Uspenski iu bind.

- Na thuaj të vërtetën. Po shkojmë vërtet për t'u graduar?

- Nga ta di unë?

Sapo Nikolai bllokoi dritaren e vogël, Aleksandri hoqi çizmen dhe nxori prej andej një rën nga granatat. Ishte kaq errësirë, sa që as Maikovi dhe as Uspenski nuk shihnin më se çfarë bënte ai.

U zvarrit deri në fund të automjetit dhe u mbështet me kurriz mbi dyert e pasme. Në sediljet e përparme ishin vetëm dy agjentë të NKVD-së. Ishin të rinj që të dy, pa përvojë, dhe asnjëri prej të dyve nuk donte ta kalonte liqenin: rreziku i sulmit gjerman ishte i gjithëpranishëm. Mungesa e përvojës së shoferit dukej nga paaftësia e tij për të ngarë automjetin më shpejt se njëzet kilometra në orë. Aleksandri e dinte se nëse gjermanët po monitoronin lëvizjet e sovjetikëve nga pozicioni i tyre i favorshëm në lartësitë e Sinjavinos, shpejtësia e ulët e kamionit nuk do t'u shpëtonte agjentëve të tyre të stërvitur. Ai vetë mund të ecte më shpejt mbi akull.

- Major, po *ty* do të të dekorojnë? - e pyeti Uspenski.

- Kështu më thanë, madje më lejuan të mbaj pistoletën. Derisa të më thonë të kundërtën, jam optimist.

- Ata nuk të lejuan ta mbaje pistoletën. Ju pashë. Ju dëgjova. Ata thjesht nuk ishin të aftë të ta merrnin.

- Jam një i plagosur në gjendje kritike, - tha Aleksandri duke nxjerrë një cigare. - Nëse donin të ma merrnin, pse të mos e bënin.

Ndezi cigaren.

- A ke dhe një për mua? - e pyeti Uspenski. - Kam tre muaj pa ndezur një cigare. Përveç infermiereve, nuk kam parë njeri tjetër. Por zërin tënd e kam dëgjuar, ama.

- Nuk duhet të tymosësh, - tha Aleksandri. - Me sa kam dëgjuar unë, ti nuk ke mushkëri.

- Një rën mushkëri e kam, por infermierja më ka mbajtur qëllimisht pak të sëmure që të mos kthehem në front. Ja se ç'bëri ajo për mua.

- Ashtu? - pyeti Aleksandri, duke u munduar të mos mbyllte sytë dhe të përfytyronte infermieren e Nikolait, atë vajzën e vogël si dielli verbues i mëngjesit të Lazarevos. Vajzën e ëmbël bionde.

- Solli akull dhe më detyroi të thithja avullin e ftohtë, që të vinin në vete mushkëritë. Do të doja që të kishte bërë pak më shumë për mua.

Aleksandri i dha një cigare. Ai donte që Nikolai të mos fliste më. E merrte me mend se Uspenskit nuk do t'i bëhej shumë qejfi po të zbulonte se Tatiana e kishte mbajtur gjallë thjesht që ta çonin drejt kthetrave të Mehlishtit.

Nxori pistoletën e tij të shërbimit të tipit “Tokarev”, u ngrit, vuri në shënjestër derën e pasme dhe shtiu, duke e hedhur drynin në erë. Maikovi klithi. Makina ngadalësoi shpejtësinë. Uspenski u shtri në dysheme dhe nuk e mbulonte më dritaren me trupin e tij. Aleksandri kishte vetëm pak sekonda kohë para se makina të ndalonte. Duke e hapur derën, ai tërhoqi siguresën e granatës, u ngjit mbi automjetin dhe e hodhi atë përpara. Ajo ra disa metra para makinës. Pak më vonë u dëgjua një shpërthim i madh. Aleksandri arriti të dëgjonte Maikovin të thoshte:

- Çfarë është ajo...

Dhimbja që ndjeu në plagë para se të binte nga makina mbi akull ishte kaq e madhe, sa që i dukej sikur po i këputeshin penjtë dhe plaga po i hapej përsëri.

Makina u trondit dhe filloi të rrëshqiste. Rrëshqiti, u kthye dhe ra anash mbi akull, duke ndaluar para gropës që ishte hapur nga granata që hodhi Aleksandri. Gropa ishte më e vogël se makina, por makina ishte më e rëndë se akulli i thyer. Akulli u ça dhe gropa u bë më e madhe.

Aleksandri u ngrit dhe vrapoi duke çaluar drejt derës së pasme, për t'i bërë shenjë dy të tjerëve të shkonin pranë tij.

- Ç'ishte ajo? - bërtiti Maikovi që kishte goditur kokën dhe i ishte çarë hunda.

- Hidhu jashtë! - thirri Aleksandri.

Maikovi dhe Uspenski iu bindën pikërisht në momentin që pjesa e përparme e makinës u zhyt në ujerat e liqenit Ladoga. Shoferi dhe shoqëruesi i tij duhet të kishin mbetur pa ndjenja, pasi nuk bënë asnjë përpjekje për të dalë nga makina.

- Major, çfarë dreqin...

- Mbylle gojën! Gjermanët do të fillojnë të shtiejnë mbi makinën për tri-katër minuta.

Aleksandri nuk kishte aspak dëshirë të vdiste mbi akull. Para se të shihte Uspenskin dhe Maikovin, kishte shpresa se do të ishte vetëm dhe, pasi të hidhte në erë automjetin e NKVD-së, do të përpiqej të

kthehej në bregun e Morozovit dhe të fshihej në pyll. Por në këtë moment të gjitha planet e tij, të gjitha shpresat e tij ishin të pakta.

- Doni të qëndroni këtu dhe të shihni si bombardojnë gjermanët, apo do të vini me mua? - u tha dy të tjerëve.

- Po të tjerët? - pyeti Uspenski.

- Janë hafije të NKVD-së. Ku beson se po të çonin që pa gdhirë? Maikovi u përpoq të ngrihej, por Aleksandri e uli poshtë.

Nuk ishin shumë larg bregut, vetëm nja dy kilometra. Agimi po përpiquej të largonte mjegullën. Automjeti po zhytej me ngadalë në akull.

- Më fal, major, - tha Uspenski, - por po thua budallallëqe. Gjatë gjithë karrierës sime ushtarake nuk kam bërë asgjë të keqe. Nuk kishin ardhur për mua.

- Jo, - iu përgjigj Aleksandri. - Kishin ardhur për mua.

- Po kush drejtin je?

Automjeti po zhdukej brenda ujërave të ngrira. Uspenski shihte një herë akullin, një herë Maikovin e çoroditur, i cili dridhej dhe i dilte gjak nga hunda, dhe një herë Aleksandrin, dhe ia plasi të qeshurës.

- Major, mund të na thuash se çfarë planesh ke? Çfarë do të bëjmë ne të tre vetëm mbi akull kur të zhytet makina?

- Mos u shqetëso, se nuk do të mbetemi për shumë kohë vetëm, - iu përgjigj duke psherëtirë Aleksandri. Tregoi me kokë për nga Morozovi dhe nxori dy pistoletat e tij. Dritat e një automjeti të lehtë ushtarak po u afroreshin. Xhipi ndaloi pesëdhjetë metra larg dhe prej andej u hodhën pesë burra me automatikë, të cilët menjëherë vunë në shënjestër Aleksandrin.

- Ngrihuni! Ngrihuni mbi akull!

Uspenski dhe Maikovi u ngritën menjëherë me duart të ngritura lart, por Aleksandrit nuk i pëlqente të merrte urdhra nga vartës të tij. Nuk kishte ndër mend të ngrihej - dhe me të drejtë. Dëgjoi fërshëllimën e një predhe dhe mbuloi kokën me duar.

Kur hapi sytë, dy prej njerëzve të NKVD-së ishin të shtrirë të palëvizur me fytyrën në akull, ndërsa tre të tjerët po i afroreshin Aleksandrit me armët drejtuar atij, duke fërshëllyer: *Poshtë, poshtë!*

*Ndoshta gjermanët i vrasin para se të më jepet mua mundësia,* mendoi Aleksandri. U përpoq të dallonte bregun. Ku ishte Sejersi?

Automjeti i palëvizshëm përbënte për gjermanët një objektiv të lehtë. Kur hafijet e NKVD-së mbërritën pranë tij, Aleksandri u propozoi të futeshin të gjithë duke vrapuar në xhip dhe të ktheheshin me shpejtësi në Morozovo.

- Jo! - ulëriti njëri prej tyre. - Duhet të të çojmë në Volhov.

U dëgjua përsëri një fishkëllimë dhe predha e radhës plasi njëzet metra larg xhipit - i vetmi mjet transporti që dispononin për të shkuar ose në Morozovo, ose në Volhov. Sapo gjermanët të godisnin xhipin, ata do të kishin vetëm pak sekonda të pambrojtur mbi liqenin e hapur kundër artilerisë gjermane.

Aleksandri ua nguli vështrimin hafijeve të NKVD-së.

- Doni të shkojmë në Volhov, nën zjarrin gjerman? Përpara, shkojmë!

Ata vështruan automjetin që ishte zhytur pothuajse krejtësisht. Aleksandri po shihte me kënaqësi se si përlesheshin instinkti i mbijetesës me urdhrat që kishin marrë.

- Shkojmë te xhipi, - tha dikush. - Të kthehemi në Morozovo dhe të presim udhëzimet. Mund ta çojmë edhe nesër në Volhov.

- Shok, mendoj se propozimi yt është shumë i arsyeshëm, - tha Aleksandri. Uspenski, i mahnitur po shihte Aleksandrin. Ai e shpërfilli.

- Ecni përpara, të gjithë. Deri në orën tre të keni hipur të gjithë në xhip, para se ta hedhin në erë.

Përveçse të mbetej gjallë, Aleksandri donte të qëndronte i thatë. Jeta e tij nuk kishte shumë vlerë po të ishte i lagur. E dinte se as në Volhov, as në Morozovo nuk do të gjente rroba të thata. Rrobat e lagura do të qëndronin mbi trupin e tij edhe pasi t'i kishin shkaktuar pneumoni dhe ta kishin vrarë.

Gjashtë burrat u zvarritën deri te xhipi. Tre burrat e NKVD-së urdhëruan të tjerët të uleshin mbrapa. Uspenski dhe Maikovi vështruan Aleksandrin të shqetësuar.

- Thjesht, futuni.

Dy nga burrat e NKVD-së u ulën mbrapa bashkë me ta. Uspenski dhe Maikovi morën frymë të lehtësuara. Aleksandri nxori cigaret. Uspenski mori një, ndërsa Maikovi refuzoi.

- Pse e bëre? - e pyeti Uspenski Aleksandrin duke pëshpëritur.

- Do të ta them, - tha Aleksandri. - E bëra sepse thjesht nuk kisha dëshirë të gradohesha sot.

Mbërritën në breg dhe u drejtuan për në komandë. Në rrugë u kryqëzuan me një ambulancë dhe Aleksandri pa Sejersin të ulur në vendin pranë shoferit. Aleksandri duke tymosur ia doli të buzëqeshte, megjithëse vuri re se gishtat po i dridheshin. Gjithçka po shkonte ashtu si duhej. Skena në liqen dukej se ishte pasojë e një sulmi gjerman. Njerëz të vdekur mbi akull dhe një automjet i zhytur në liqen. Sejersi do të plotësonte një certifikatë vdekjeje, do ta nënshkruante dhe Aleksandri do të zhdukej nga faqja e dheut. NKVD-ja do të ishte e kënaqur që i arrestuari i saj ishte zhdukur, dhe derisa Stepanovi të merrte vesh të vërtetën, Tatiana dhe Sejersi do të kishin ikur me kohë. Kështu nuk do të duhej që Stepanovi t'i thoshte gënjeshtër Tatianës.

Në mungesë të informacioneve të sakta, ai vetë do të besonte se Aleksandri kishte vdekur në liqen bashkë me Uspenskin dhe Maikovin.

Kaloi dorën mbi kokën e tij pa kapelë dhe mbylli sytë, duke i hapur përsëri shpejt. Peizazhi i zhveshur rus ishte më e bukur sesa ajo pas qepallave të tij të mbyllura.

Kështu do të dilnin të fituar të gjithë. NKVD-së nuk do t'i duhej t'i jepte shpjegime Kryqit të Kuq Ndërkombëtar; Ushtria e Kuqe do të shtirej sikur mbante zi për të vdekurit dhe Mehlishi prapë do ta kishte në dorë Aleksandrin. Nëse donin ta vrisnin, do ta kishin bërë menjëherë. Por nuk kishin marrë urdhër të tillë dhe Aleksandri e dinte arsyen. Macja donte të luante me miun para se ta shqyente.

Kur arritën në Morozovo, ora kishte vajtur tetë dhe reparti do të zgjohej, dhe ata duhej të qëndronin të fshehur derisa të transferoheshin përballë, dhe pastaj i hodhën në një burg që kishin ngritur në bodrumet e një shkolle të vjetër të fshatit. Ishte një qeli prej çimentoje pak më e gjerë se një metër dhe më pak se dy metra e gjatë. Burrat e NKVD-së urdhëruan tre të arrestuarit të shtriheshin përtokë dhe të mos lëviznin prej andej.

Qelia ishte shumë e vogël për Aleksandrin, nuk kishte hapësirë të mjaftueshme që të shtrihej. Sapo ikën rojat, tre burrat u ulën përtokë me gjunjët të mbledhura. Aleksandri ndiente plagën t'i pulsonte. Kontakti me dyshe-menë e ftohtë nuk i bënte mirë.

Uspenski vazhdonte t'i bënte pyetje.

- Çfarë do? Mos më pyet më, - i tha Aleksandri. - Të paktën kështu nuk do të të duhet të gënjeshtër kur të të marrin në pyetje.



- Pse të na marrin në pyetje?

- Të kanë arrestuar. A nuk është e qartë?

Maikovi vështrroi duart e tij.

- Oh, jo, - tha ai. - Kam gruan, nënën, dy fëmijët e vegjël. Ç' do të bëhet me ne?

- Ç' do të bëni? - tha Nikolai. - E kush je ti? Edhe unë kam gruan dhe dy djemtë... dy djem të vegjël. Dhe shpresoj se nëna ime jeton ende.

Maikovi nuk foli, por që të dy e kthyen vështrimin nga Aleksandri. Maikovi i uli sytë, por Uspenski jo.

- Në rregull, - tha Uspenski. - Çfarë ke bërë?

- Toger! Aleksandri e shfrytëzonte epërsinë e tij sa herë që ishte e nevojshme. - Mjaft kam dëgjuar prej teje!

Uspenski nuk sprapsej.

- Nuk dukesh si fanatik fetar.

Aleksandri nuk foli.

- As si çifut, as si tregtar në tregun e zi. Mos je gjë kulak? Anëtar i Kryqit të Kuq Politik? Filozof i fshehtë? Socialist? Historian? Sabotator i prodhimit bujqësor? Agjikator antisovjetik?

- Jam tetar, drejtues qerreje, - iu përgjigj Aleksandri.

- Do të hash dhjetë vjet burg për këtë! E ku është qerrja jote? Do t'i hynte në punë gruas sime për të transportuar qepë nga fushat. Po na thua që neve na arrestuan se kishim fatin e keq të kishim krevatet pranë teje?

Maikovi lëshoi një dënesë.

- Po ne nuk dimë asgjë! Nuk bëmë asgjë!

- Ashtu? - tha Aleksandri. - Këtë t'ia thuash atyre muzikantëve dhe audiencës që u mblodhën një natë në fillimet e viteve '30 përreth një pianoje, pa marrë më parë leje nga sovjeti i zonës. Kishin mbledhur të holla për të blerë verë, dhe kur i arrestuan për agjitacion antisovjetik, i akuzuan se ato pará do të shkonin për të përforcuar borgjezinë pothuajse të zhdukur. Bënë nga tre deri në dhjetë vjet burg secili, - ndaloi për një moment dhe pastaj shtoi: - Domethënë, jo të gjithë, vetëm ata që pranuan krimin që kishin bërë. Ata që kundërshtuan ta pranonin, i ekzekutuan.

Uspenski dhe Maikovi e shihnin me sy të zgurdulluar.

- Po ti nga e di këtë? - e pyeti i pari.

- E di, se unë isha katërmbëdhjetë vjeç dhe munda të ikja nga dritarja para se të më kapnin.

U dëgjuan hapa dhe heshtën të gjithë. Aleksandri u ngrit dhe drejtoi aq sa mundej shtatin e tij. Kur po hapej dera, i tha Maikovit:

- Tetar, imagjino sikur jeta jote e deritanishme nuk ekziston më. Sikur t'i morën të gjitha dhe nuk të ka mbetur më asgjë...

- Hajde, Belov! - thirri një burrë me trup të lidhur dhe i armatosur me një pushkë të vjetër "Nagant".

- Vetëm kështu mund t'ia dalësh mbanë, - shtoi Aleksandri duke dalë nga qelia dhe duke dëgjuar derën të kërciste pas tij.

E kishin vënë të rrinte në një klasë të vogël të shkollës së vjetër, përpara një banke dhe tabelës së zezë. Dhe priste nga momenti në moment të shihte mësuesin e tij të vjetër të hynte dhe të vazhdonte mësimin për të këqijat e imperializmit.

Në vend të mësuesit hynë dy burra. Tani në sallë gjendeshin katër vetë. Aleksandri i ulur në karrige, një roje në fund të klasës dhe dy të sapoardhurit të ulur në tavolinën e mësuesit. Njëri prej tyre ishte tullac dhe shumë i dobët, me hundë të gjatë dhe pamje të mendueshme. U prezantua me edukatë, duke thënë se quhej Riduard Morozov.

- Morozov, prej ku e mori emrin ky fshat? - pyeti Aleksandri.

- Jo, - u përgjigj tjetri duke buzëqeshur me çiltërsi.

I dyti ishte tej mase i shëndoshë, krejt tullac dhe me një hundë rrumbullake si llambë, plot me kapilarë të çarë. Dukej që pinte shumë. Me më pak edukatë se i pari, u prezantua si Miterandi dhe kjo për pak sa nuk e bëri Aleksandrin që t'ia plaste të qeshurës, pasi Miterand quhej udhëheqësi i Lëvizjes së Rezistencës në Francë nën regjimin nazist.

- E di pse gjendesh këtu, major Belovi? - e pyeti Morozovi me edukatë dhe me një buzëqeshje të ngrohtë, sikur po diskutonin miqësisht. Pas pak Miterandi do t'i ofronte çaj, ndoshta dhe pak vodkë. Aleksandri e mendoj si shaka, por çuditërisht një shishe vodkë u shfaq nga mbrapa tavolinës bashkë me tri gota të vogla. Morozovi i mbushi.

- Po, - iu përgjigj me qejf pyetjes së tij Aleksandri. - Dje më thanë që do të gradohem. Do të bëhem nënkolonel. Jo, faleminderit, - tha duke mos pranuar gotën që i ofroi tjetri.

- Po mohon mikpritjen tonë, shoku Belov?

- Major Belov, - ngriti zërin Aleksandri. U ngrit dhe vështroi burrin që qëndronte para tij. - Ti ke ndonjë gradë? Tjetri nuk u përgjigj. - E prisja, - vazhdoi Aleksandri. - Nuk ke veshur uniformë. Atëherë, nuk do ta marr pijen tuaj dhe nuk do të ulem derisa të më thoni se çfarë doni prej meje. Do të bashkëpunoja me gjithë qejf, shokë, - shtoi ai, - por mos më fyeni duke u hequr si shokët e mi më të mirë. Çfarë kërkoni prej meje?

- Je nën arrest.

- Ashtu?... Pra, nuk po shkoj për t'u graduar? Bukur. Ndërkaq, nuk më thatë se për çfarë më doni. Nuk jam i sigurt nëse e dini edhe ju vetë. Pse nuk shkoni të gjeni dikë që të dijë ç'të më thotë? Dhe, deri sa ta gjeni, më çoni përsëri në qelinë time dhe mos më harxhoni kohën.

- Major! - thirri Morozovi. Zëri i tij nuk ishte më i këndshëm. Që të dy burrat e kishin pirë vodkën. Aleksandri buzëqeshi. Nëse i mbante në klasë duke pirë, ata do ta shoqëronin vetë deri në kufirin me Finlandën, duke i folur me një anglishte të çalë. Ata e thërrisnin major. Aleksandri e kuptonte mirë psikologjinë e gradës. Në ushtri kishin vetëm një rregull: duhej t'u flisje gjithnjë me respekt eprorëve. Hierarkia ishte vendosur.

- Major, - përsëriti Morozovi, - qëndro këtu.

Aleksandri u kthye te karrigia e tij.

Miterandi i fliste me zë të ulët rojës. Aleksandri nuk arrinte të dëgjonte fjalët, por kuptonte tonin. Duhej të vinte dikush i një rangu më të lartë që të merrej me Aleksandrin, por, derisa të vinte ai, ata do të përpiqeshin ta mposhtnin.

- Major, ngrihu dhe vendosi duart mbrapa, - i tha Morozovi.

Aleksandri hodhi në dysheme cigaren që po tymoste, e shkeli me këmbë dhe u ngrit. Roja i mori pistoletën dhe thikën, dhe të gjithë bashkë kontrolluan çantën e tij. Nuk gjetën asgjë për t'i marrë - vetëm fasha, stilolapsa dhe fustanin e bardhë të asaj. Vendosën t'i merrnin dekoratën nga gjoksi, t'i shqepnin spaletat dhe t'i thoshin se nuk e kishte më gradën e majorit. Por as nuk i thanë për çfarë ishte akuzuar dhe as i bënë ndonjë pyetje.

U kërkoi që t'i jepnin çantën, dhe ata qeshën. Kur po e merrnin prej andej, hodhi një vështrim të fundit mbi fustanin e bardhë të

Tatianës. Edhe një gjë tjetër që do të linte pas.

E çuan në një qeli izolimi, pa dritare, pa Uspenskin, pa Maikovin. As krevat, as ndonjë stol, as ndonjë batanije. Oksigjeni hynte vetëm kur rojat hapnin derën ose nga një vrimë e vogël në tavan e cila, sipas të gjitha gjasave, përdorej për të hedhur gaz helmues.

E kishin lënë të mbante orën, dhe ngaqë nuk i bënë kontroll fizik, i kishin lënë edhe ilaçet që i kishte fshehur te çizmet e tij ushtarake. Por nuk do të ishin të sigurt aty për shumë kohë. Ku t'i vinte? U mendua pak dhe i futi në mbathje. Duhej të kërkonin me shumë kujdes që t'i gjenin aty.

Ngaqë përkulej dhe drejtohej, shpatulla kishte filluar t'i dhembte shumë. Mendoi të bënte një dozë morfine, por e hodhi poshtë këtë ide dhe filloi të përtypte një tabletë sulfamid. Ashtu, pa kërkuar ujë. Ishte shumë e hidhur dhe i shkaktonte djegësirë.

Aleksandri u ul përtokë, duke marrë me mend se rojat nuk mund ta shihnin për shkak të errësirës, dhe mbylli sytë. Ose ndoshta i kishte ende të hapura; ishte e vështirë të kuptonte dallimin. Fundja, nuk kishte rëndësi. Rrinte ulur dhe mendohej. A kishte mbaruar dita? A kishte kaluar një ditë? Donte të tymoste. Qëndroi pa lëvizur. A kishin ikur Sejersi me Tatianën? A e kishte lejuar veten Tanja që të bindej, të nxitej, të ngushëllohej? A ishte futur në makinën e Sejersit bashkë me gjërat e saj? A ishin larguar ata nga Morozovo? Çfarë nuk do të jepte Aleksandri për ta mësuar. Kishte frikë se doktor Sejersi nuk do të arrinte t'ia mbushte mendjen Tatianës dhe se ajo do të kishte qëndruar. Nëse ajo ishte akoma në Morozovo, ai e dinte se sapo të fillonin ta merrnin në pyetje dhe të merrnin vesh për Tatianën, ai do të merrte fund. Nuk merrte dot frymë kur mendonte se ajo mund të ishte aq afër. Duhet të vononte sa më shumë NKVD-në deri sa të ishte i sigurt se ajo kishte shpëtuar. Sa më shpejt të ikte ajo, aq më shpejt do të mundej ai t'i dorëzohej shtetit.

Aleksandri kishte përshtypjen se ajo ishte shumë afër. Ai thajse mund të zgjaste dorën dhe të prekte fustanin e saj brenda çantës së tij, dhe të shihte atë vetë me fustanin e bardhë me trëndafila të kuq, flokët që i valëviteshin dhe dhëmbët që i shkëlqenin. Ajo ishte shumë afër. Ai nuk kishte nevojë të prekte fustanin. Ai nuk kishte nevojë për ngushëllim, ndërsa ajo po. Kishte kaq shumë nevojë për të. Si do t'ia dilte mbanë pa të? Aleksandri kishte nevojë të mendonte për diçka tjetër.

- Idiot! - u dëgjua një zë nga jashtë. - Si do ta ruash të burgosurin nëse nuk ka dritë? Mund të ketë vrarë veten gjatë kësaj kohe aty brenda dhe ti të mos marrësh vesh asgjë! Idiot!

U hap dera dhe hyri Miterandi duke mbajtur një llambë vajguri.

- Duhet të jesh vazhdimisht i ndriçuar, - tha ai.

- Kur do të më thotë dikush se ç'bëhet këtu? - e pyeti Aleksandri.

- Nuk do të na bësh ti pyetje! - hungëriti Miterandi. - Nuk je më major! Asgjë nuk je! Do të presësh të të thërrasim kur të jemi gati.

Ky dukej se ishte qëllimi i vetëm i vizitës së Miterandit: t'i bërtiste Aleksandrit.

Pasi iku Miterandi, roja i solli Aleksandrit pak ujë dhe treçerekë kile bukë. Aleksandri hëngri bukën, piu ujin, dhe filloi të kërkonte në dysheme për ndonjë vrimë. Nuk donte që dhoma të ishte e ndriçuar. Aleksandri fiku llambën. Nuk donte t'i digjej oksigjeni. Duke hapur pjesën e poshtme të llambës, derdhi vajgurin te vrima që kishte gjetur në dysheme. Roja u fut në dhomë duke bërtitur.

- Pse e fike llambën?

- Mbaroi vajguri, - tha Aleksandri. - A ke për ta mbushur?

Roja i tha se nuk kishte.

- Sa keq, - tha Aleksandri.

Ai fjeti në errësi, i ulur te cepi i dhomës, me kokën mbështetur në mur. Kur u zgjua ishte akoma errësi. Nuk ishte i sigurt nëse ishte zgjuar. Në ëndërr kishte hapur sytë: ishte errësi. Kishte parë Tatianën, dhe kur u zgjua mendoi për të. Ëndërrat dhe realiteti ishin përzier. Aleksandri nuk e dinte ku mbaronte makthi dhe ku fillonte jeta e vërtetë. Ëndërroi sikur mbylli sytë dhe e zuri gjumi.

E ndiente veten të shkëputur nga Morozovo, nga spitali, nga jeta e tij, por këtë shkëputje, çuditërisht, e ndiente të rehatshme. Kishte ftohtë. Kjo ndjesi sikur e ngushtoi pak atë shkëputje nga trupi i tij i vuajtur. Shpatulla i dhembte shumë. Shtrëngoi dhëmbët dhe mbylli sytë në errësi.

### *Harold dhe Xhein Barrington, 1933*

Hitleri ishte bërë kancelar i Gjermanisë. Presidenti Von Hindenburg kishte "dhënë dorëheqjen". Aleksandri ndiente në

atmosferë se po përgatitej diçka ogurzezë, por nuk e dinte se çfarë. Kishte kohë që nuk shpresonte për më shumë ushqim, për këpucë të reja dhe për një pallto të ngrohtë.

Në verë nuk i nevojitej palltoja. Barringtonët e kishin kaluar korrikun e vitit 1933 në Krasnaja Poliana. Ishte bukur aty, në ato dy dhoma që kishin marrë me qira nga një e ve lituaneze dhe djali i saj pijanec.

Një pasdite, pas një pikniku me vezë të ziera, domate, sallam bolonjez dhe vodka të sjellë nga mamaja e tij (*Mama, që kur ke filluar të pish vodka?*), Aleksandri ishte shtrirë mbi hamak duke lexuar, kur dëgjoi në pyll një zhurmë pas tij. Ktheu kokën dhe pa prindërit e tij. Ata qëndronin pranë lirishtës buzë liqenit dhe po hidhnin guriçka në ujë, duke folur me zë të ulët. Aleksandri nuk ishte mësuar t'i shihte duke folur qetë, aq e trazuar ishte bërë marrëdhënia e tyre. Normalisht, ai thjesht do t'i kthehej librit të tij, por biseda e qetë, afrimiteti i tyre gazmor... nuk dinte çfarë të mendonte. Haroldi mori guriçkat nga duart e Xheinit dhe e tërhoqi pranë vetes. Mbajti njërin krah rreth belit të saj dhe dorën tjetër ia vendosi mbi dorë. Pastaj ai e puthi dhe filluan të vallëzonin. Po vallëzonin nën ritmin e një vals, kur Aleksandri dëgjoi të atin që po këndonte - *po këndonte!*

Akoma nën ritmin e valsit, trupat e tyre u vërtitën në një përqafim, ndërsa Aleksandri vështronte një skenë midis prindërve të tij, të cilën nuk e kishte parë ndonjëherë më parë, e as do ta shihte përsëri; ai ndjeu një lumturi të cilën nuk mundej as ta përcaktonte e as ta përshkruante.

Ata u larguan pak nga njëri-tjetri, kthyen vështrimin drejt tij dhe i buzëqeshën. Ai u ktheu një buzëqeshje të druajtur, pa mundur të kthente shikimin diku tjetër. Ata iu afruan hamakut. Dora e babait të tij ishte akoma rreth belit të së ëmës.

- Është përvjetori ynë sot, Aleksandër.
- Babai yt po më këndonte këngën e përvjetorit, - i tha Xheini.
- Atë këngë vallëzuam ditën kur u martuam, para tridhjetë e një vitesh. Unë isha nëntëmbëdhjetë vjeçe. Ajo i buzëqeshi Haroldit.
- Këtu do të qëndrosh, mbi hamak, duke lexuar?
- S'kam ndër mend të lëviz.
- Mirë, pra, - tha Haroldi duke e marrë Xheinin nga dora dhe duke shkuar drejt shtëpisë.

Aleksandri u kthye te libri i tij, por pasi e shfletoi për gati një orë, kuptoi se nuk mbante mend as edhe një fjalë nga ato që kishte lexuar.

Dimri erdhi shumë shpejt.

Çdo të enjte në mbrëmje pas buke, Haroldi merrte Aleksandrin për dore dhe shkonin me këmbë në mes të të ftohtit në Arbat, në rrugën ku mblidheshin shitësit e rrugës, muzikantët, rapsodët, shkrimtarët dhe poetët dhe disa plaka që shisnin çuçka nga epoka e carit. Aty afër, në një apartament të vogël me dy dhoma të mbushura me tym, një shoqëri prej të huajsh dhe sovjetikësh komunistë të përkushtuar mblidheshin nga ora tetë deri në dhjetë për të pirë ndonjë gotë, për të tymosur ndonjë cigare dhe për të diskutuar se si do ta bënin më të mirë komunizmin në Bashkimin Sovjetik, se si do të krijonin një orë e më parë shoqërinë pa klasa dhe do të shfuqizonin nevojën e shtetit, të ushtrisë dhe të policisë, përderisa nuk do të kishte më arsye për konflikt.

- Marksi tha se konflikti i vetëm është konflikti ekonomik midis klasave. Kur ky konflikt të mos ekzistojë, nuk do të jetë më e nevojshme ekzistenca e policisë. Çfarë presim, qytetarë? Mos kjo gjë kërkon më shumë kohë nga sa e imagjinonim?

Ky ishte Haroldi.

Dhe Aleksandri, të cilit iu kujtua diçka që kishte lexuar, u tha:

- Për sa kohë do të ekzistojë shteti, nuk mund të ekzistojë liria. Kur të ekzistojë liria, nuk do të ekzistojë më shteti.

Dhe Haroldi buzëqeshi krenar që i biri citonte Leninin.

Në ato takime, Aleksandri zuri miqësi me një burrë gjashtëdhjeteshtatëvjeçar të quajtur Slavan, i cili ishte i gjithi gri dhe dukej sikur kishte rrudha edhe mbi kokë, por sytë e tij ishin blu vigjilentë, dhe kishte gjithmonë një buzëqeshje të hidhur në fytyrë. Nuk fliste shumë, por Aleksandrit i pëlqente shikimi i tij ironik dhe ngrohtësia që përcillte sa herë që shikonte Aleksandrin.

Pas dy vjetësh takime të tilla, Haroldi dhe pesëmbëdhjetë të tjerë u thirrën në kryesinë e Partisë, ose komiteti “Oblastniji”, ku iu kërkuan që të gjenin një temë tjetër për të diskutuar, meqë fakti që kërkonin mënyra se si të funksiononte më mirë komunizmi në Rusi tregonte që tani nuk funksiononte dhe aq mirë. Kur ia tha i

ati, Aleksandri e pyeti se nga e dinte Partia se çfarë diskutonin pesëmbëdhjetë të dehur në një qytet prej pesë milionë banorësh. Dhe Haroldi iu drejtua me një citat të Leninit:

- “E vërteta është se liria është shumë e vlefshme. Kaq me vlerë, sa duhet të jepet me tollon.” Sigurisht që kanë mënyrat e tyre për ta marrë vesh se për çfarë flasim ne. Ndoshta ai Slavani është spiuni. Po të isha në vendin tënd, nuk do t’i flisja më.

- Nuk është ai spiuni, baba.

Dhe pas kësaj, grupi në mbledhjet e së enjtes lexonte pjesë nga libri “Ç’duhet të bëhet?” i Leninit, nga broshurat e Roza Luksemburgut dhe nga “Manifesti Komunist” i Marksit.

Haroldi shpesh përmendte aprovimin e mbështetësve amerikanë të komunizmit, për të treguar se komunizmi sovjetik po fillonte ngadalë të pranohej në nivel ndërkombëtar dhe se ishte thjesht çështje kohe.

- Shikoni se çfarë tha Isadora Dankan për Leninin para se të vdiste, - tha Haroldi dhe citoi: - “Shumë të tjerë donin veten e tyre, pará, teori, pushtet. Lenini donte bashkëqytetarin e tij... Lenini ishte Zoti, siç ishte dhe vetë Krishti Zot, sepse Zoti është dashuri, si Krishti dhe Lenini ishin dashuri.”

Aleksandri i buzëqeshte të atit në shenjë aprovimi.

Një natë, për shumë orë me radhë, pesëmbëdhjetë burra, përveç Slavanit të heshtur, po përpiqeshin t’i shpjegonin Aleksandrit katërmëdhjetëvjeçar domethënien e termit “zbritja e vlerës”. Se si një send, këpuçë për shembull, mund të kushtonte më pak pasi të ishte prodhuar, sesa shuma totale e materialeve të para dhe punës.

- Çfarë nuk ke kuptuar? - i bërtiti një komunist i irrituar, i cili ditën punonte si inxhinier.

- Pjesën ku nxjerr pará nga shitja e këpuçëve.

- E kush tha se nxjerr pará? A nuk e ke lexuar “Manifestin Komunist”?

- *E kam lexuar.*

- Epo, nuk mban mend se ç’ka thënë Marksi? Diferenca midis sasisë që u paguan fabrika punëtorëve dhe koston së vërtetë të këpuçëve, është vjedhje kapitaliste dhe shfrytëzim i proletarietit. Pikërisht këtë po përpiqet të zhdukë komunizmi. Nuk e ke kuptuar akoma?



- Po, por zbritja e vlerës nuk eliminon thjesht fitimin, - tha Aleksandri. - Zbritja e vlerës nënkupton se kushton më shumë të prodhosh këpucët sesa t'i shesësh. Kush do ta paguajë diferencën?

- Shteti.

- E ku do t'i gjejë paratë shteti?

- Shteti do të paguajë, përkohësisht, me më pak pará punëtorët që të prodhojnë këpucët.

Aleksandri nuk foli.

- Pra, gjatë një periudhe kur inflacioni global ka arritur majat, Bashkimi Sovjetik do t'i paguajë punëtorët më pak? Sa më pak?

- Thjesht më pak.

- E si do t'i blejmë *ne* këpucët?

- Përkohësisht, nuk do t'i blejmë. Do të duhet të veshim këpucët që kishim vjet. Deri sa të marrë veten shteti.

Inxhinieri i buzëqeshi.

- Mirë e ke, - tha qetësisht Aleksandri. - Shteti, ama, erdhi mjaft në vete sa për të paguar për *Rolls Royce*-n e Leninit, apo jo?

- E ç'lidhje ka *Rolls Royce* i Leninit me temën që po diskutojmë ne? - bërtiti inxhinieri. Slavani qeshi. - Bashkimi Sovjetik do t'ia dalë për bukuri, - vazhdoi inxhinieri. - Është akoma në hapat e parë. Po të lindë nevoja, do të marrë hua nga jashtë.

- Me gjithë respekt, qytetar, por nuk ka asnjë shtet në botë që t'i japë përsëri pará Bashkimit Sovjetik, - tha Aleksandri. - Që nga ngjarjet e 1917-s, pas Revolucionit Bolshevik, nuk kanë për të parë kurrë pará nga jashtë. Bankat botërore janë të mbyllura për Bashkimin Sovjetik.

- Duhet të jemi të duruar. Ndryshimet nuk ndodhin brenda natës. Ti duhet të kesh një sjellje më pozitive. Harold, çfarë i ke mësuar djalit?

Haroldi nuk foli, por kur po ktheheshin në shtëpi, i tha:

- Si e ke hallin, Aleksandër?

- Nuk kam gjë.

Aleksandri donte të kapte dorën e babait të tij, por papritur ndjeu se ishte shumë i madh tashmë. Tek po ecte në krah të tij, e mori nga dora, gjithsesi.

- Ekonomia nuk po na ecën. Ky shtet revolucionar është ndërtuar mbi parime kryesisht ekonomike, dhe e vetmja gjë që nuk ka zgjidhur

është se si do ta paguajë forcën punëtore. Punëtorët nuk ndihen më si proletarietë, por ashtu si fabrikat dhe makineritë, prona të shtetit. Jemi këtu mbi tre vjet. Sapo mbaruam planin e parë pesëvjeçar. Dhe kemi kaq pak pará. Njëpër dyqane s'ka asgjë, dhe...

Donte të thoshte: *dhe njerëzit vazhdojnë të zhduken*, por e mbajti gojën mbyllur.

- Epo, çfarë mendon se po bëhet në Amerikë? - pyeti Haroldi.  
- Papunësia ka vajtur në tridhjetë për qind, Aleksandër. Mendon se është më mirë andej? E gjithë bota po vuan. Shiko Gjermaninë: inflacion i jashtëzakonshëm. Tani Adolf Hitleri po u premtun gjermanëve se do t'u japë fund problemeve të tyre. Ndoshta do t'ia dalë. Gjermanët, sigurisht që aty i kanë shpresat. Epo, shokët Lenin dhe Stalin i premtuan Bashkimit Sovjetik të njëjtën gjë. Si e quajti Stalini Rusinë? Amerika e dytë, apo jo? Duhet të kemi besim dhe duhet ta ndjekim. Do ta shohësh se gjithçka do të rregullohet.

- E di, baba. Ke të drejtë. Por, gjithsesi, e di se shteti duhet t'i paguajë punëtorët disi. Sa më pak mund t'ju paguajnë? Ne, edhe kështu nuk mund të përballojmë të paguajmë për qumësht dhe mish. Jo se ka mbetur gjë, edhe sikur të kishim pará. Deri kur do të vazhdojnë të ta ulin pagën? Do të kuptojnë se vazhdimisht u duhen më shumë pará, jo më pak, dhe e vetmja kosto e pandryshueshme është paga juaj. Çfarë do të bëjnë? Do të vazhdojnë të ulin pagat, deri... deri kur?

- Nga se ke frikë? - tha Haroldi duke i shtrënguar dorën Aleksandrit. - Kur të rritesh do të kesh një punë të rëndësishme. Akoma do që të bëhesh arkitekt? Do të bëhesh. Do të kesh një karrierë.

- Kam frikë, - tha Aleksandri duke i hequr dorën të atit, - se është thjesht çështje kohe para se, jo vetëm unë, por të gjithë të bëhemi asgjë më shumë se kapital i ngrirë.

## KAPITULLI VI

*Eduardi dhe Viki, 1943*

**T**ATIANA qëndronte pranë dritares duke mbajtur në një rëndë dorë foshnjën e saj dhe në tjetrën një libër. Sytë e kish të mbyllur, por i hapi menjëherë sapo ndjeu frymëmarrjen e dikujt.

Pak më tutje qëndronte dr. Eduard Ladlou, i cili po e vështronte me kuriozitet dhe shqetësim. Ajo e dinte se, që kur kishte lindur fëmija, ishte shumë e heshtur. Nuk mendonte se kjo ishte dhe aq e pazakontë. Shumë njerëz që kishin kaluar këtej, duke lënë pas jetën e tyre të mëparshme, duhet të kishin qenë shumë të heshtur, pasi në këto dhoma të vogla të bardha ata kuptonin pikërisht se sa e madhe ishte ajo që kishin lënë pas, ndërkohë që vështrimi iu ndal te veshja e Statujës së Lirisë.

- Kisha frikë mos të të binte fëmija nga duart, - i foli qetë doktori.  
- Nuk doja të të trembja...

Ajo i tregoi se sa fort po e mbante Antonin.

- Mos u shqetëso.

- Çfarë po lexon?

Tatiana vështrroi librin që mbante në dorë.

- Nuk po lexoj, thjesht po... rri.

Ishte *Kalorësi i Bronzës dhe poezi të tjera* të Aleksandër Pushkinit.

- Je mirë? Është pasdite herët dhe nuk doja të të zgjoja, - foli sërish doktori.

Ajo fërkoj sytë. Fëmija po flinte akoma.

- Ky fëmijë nuk fle gjithë natën, fle vetëm ditën, - shtoi ajo.

- Si e ëma.

- E ëma në orarin e tij. Ajo buzëqeshi. - Gjithçka në rregull?

- Po, po, - tha dr. Lادلou me nxitim. - Dikush nga Shërbimi i Emigracionit do të bisedojë me ty.

- Çfarë do?

- Çfarë do? Do të të jap një mundësi që të qëndrosh në Shtetet e Bashkuara.

- Por mendoja, sepse djali im... lindi në terren amerikan...

- Në tokën amerikane, - e korrigjoi dr. Lادلou me lezet. - Prokurori i përgjithshëm do që ta shqyrtojë çështjen tënde personalisht. Heshti për pak minuta. - Nuk na vijnë shumë udhëtarë të paligjshëm tani në kohë lufte. Dhe veçanërisht nga Bashkimi Sovjetik. Është e diçka e pazakontë.

- A jeni i sigurt se ai do të vijë këtu? - pyeti ajo. - I the që jam me tuberkuloz?

- I thashë. Do të vërë maskë. Vërtet, si je? Nxjerr akoma gjak kur kollitesh?

- Fare. Dhe nuk kam më temperaturë. Ndihem më mirë.

- Del ndopak jashtë?

- Po. Më pëlqen ajri i detit.

- Mirë. Ai e vështroi i entuziazmuar. Ajo bëri të njëjtën gjë. - Ajri i detit është i këndshëm. Pastaj ai u kollit dhe vazhdoi: - Infermiereve u ka bërë shumë përshtypje që tuberkulozi nuk arriti t'i ngjitej edhe djalit tuaj.

- Eduard, shpjegoju se, - tha Tatiana, - nëse vijnë për të më parë dhjetë mijë vetë në ditë për një vit të tërë, vetëm dhjetë mes gjashtëmbëdhjetë do t'u ngjitet tuberkulozi prej meje. Kjo sëmundje nuk është kaq ngjitëse sa mendojnë të tjerët. Pra, nëse ka kurajë ky njeri nga Ministria, le të vijë. Por thuaji se ekzistojnë mundësitë që të sëmuret. Tregoji, gjithashtu, që nuk flas mirë anglisht.

Eduardi i tha duke buzëqeshur se anglishten e fliste për bukuri, dhe pak më vonë e pyeti nëse dëshironte që të qëndronte edhe ai.

- Jo, jo, faleminderit.

Tomë, i ardhur nga Shërbimi i Emigracionit, u ul dhe bisedoi me të për gati pesëmbëdhjetë minuta, që të verifikonte se sa mirë e fliste

anglishten. E pyeti për profesionin e saj dhe ajo iu përgjigj se ishte infermiere, se dinte të qepte dhe të gatuar.

- Për shkak të luftës ka kërkesa të mëdha për infermiere, - i tha ai.

- Po. Dhe veçanërisht këtu në Elis, - u përgjigj Tatiana, e cila mendonte se Brenda ushtronte profesionin e gabuar.

- Nuk kemi shumë raste si ky i yti.

Ajo nuk iu përgjigj.

- Dëshiron të qëndrosh në Shtetet e Bashkuara?

- Sigurisht.

- Mendon se mund të punosh dhe të ndihmosh në përpjekjen luftarake?

- Sigurisht.

- Kjo është shumë e rëndësishme, besoj se e di? Jemi në luftë, vendi është i paqëndrueshëm, duhet të bindemi se do të jesh produktive. Dhe, natyrisht, besnike ndaj këtij vendi dhe jo ndaj atdheut tënd të mëparshëm.

- Mos u shqetëso fare për këtë, - tha ajo. - Sapo të shërohesh, do më lejojnë që të punoj, do të filloj punë... si infermiere, rrobaqepëse, kuzhinierë. Të tria së bashku, po të duhet. Sapo të bëhem mirë do të bëj ç'të jetë e nevojshme.

Tomi u ngrit, shtrëngoi maskën në fytyrë dhe u drejtua për nga dera, a thua se në atë moment u kujtua për sëmundjen e saj.

- Ku do të banosh? - e pyeti ai. Zëri mezi u dëgjua poshtë maskës.

- Dua të jetoj këtu.

- Kur të bëhesh më mirë, duhet të gjesh një apartament.

- Po. Mos u shqetëso.

Ai tundi kokën dhe shënoi diçka në bllokun e tij.

- Çfarë emri do të mbash? Në dokumentet që kishe me vete, vura re se u largove nga Bashkimi Sovjetik si Xhein Barrington, si infermiere e Kryqit të Kuq.

- Po.

- Të falsifikuara janë këto dokumente?

- Nuk po kuptoj se ç'është të thuash.

Tomi heshti për pak.

- Kush është Xhein Barrington?

Tani e kishte radhën Tatiana të heshte.

- E ëma e bashkëshortit tim, - tha më në fund Tatiana.

Tom i psherëtiu:

- Barrington? Nuk duket si mbiemër rus.

- Bashkëshorti im ishte amerikan, - shtoi Tatiana dhe uli sytë.

Tom i hapi derën.

- Këtë emër doni të përdorni dhe të keni në kartën e identitetit?

- Po.

- Jo emrin tënd rus?

Ajo heshti për këtë.

Tom i u afrua më shumë.

- Disa prej emigrantëve që vijnë këtu duan të ruajnë diçka nga e kaluara e tyre. Në përgjithësi nuk ndryshojnë emrin, por vetëm mbiemrin. Mendoje edhe një herë nëse e dëshiron një gjë të tillë.

- Unë, jo, - u përgjigj Tatiana. - Ndryshoji të gjitha. Nuk dua të ruaj asgjë nga e kaluara.

Ai u përkul dhe shkroi përsëri në bllokun e tij.

- Dakord, atëherë. Xhein Barrington.

Kur ai u largua, Tatiana u ul në dritare dhe, duke vështuar portin e Nju-Jorkut dhe Statujën e Lirisë, hapi *Kalorësin e Bronztë* dhe preku fotografinë e Aleksandrit që e kishte fshehur në faqet e tij. Përkëdheli fytyrën dhe trupin e tij, i pëshpëriti fjalë të ëmbla në rusisht, por këtë herë për të ngushëlluar *veten* - as Aleksandrin dhe as djalin e saj.

*Sura, Sura, Sura*, - pëshpëriste Xhein Barrington, e njohur dikur si Tatiana Metanova.

Tatiana i kalonte ditët duke i dhënë gjë Antonit, duke e ndërruar, duke larë rrobat e pakta në lavamanin e banjës dhe duke bërë shëtitje të shkurtra jashtë, në ajrin e pastër, duke e mbajtur Antonin të mbështjellë me një batanije. Brenda ia çonte mëngjesin në dhomë. Aty e hante edhe drekën, edhe darkën. Tatiana e mbante gjithë kohën në krahë Antonin, përveçse kohës kur flinte. Dhe shihte vetëm dy gjëra: Nju-Jorkun dhe djalin e saj. Dhe e mbyste vetmia, ditë e natë. Brenda dhe dr. Ladlou thoshin se po shërohej. Ndërsa vetë ajo thoshte se ndodhej në izolim.

Një mëngjes, aty nga fundi i korrikut, duke ndier se po e mbyste vetmia, Tatiana doli në korridor për të bërë një shëtitje, ndërkohë që Antoni flinte. Në korridor dëgjoji rënkime, por duke ndjekur zërat, u

gjend në një pavijon plot me burra të plagosur. Brenda ishte e vetmja infermiere e turnit dhe dukej qartë se nuk ishte fare e kënaqur nga kjo situatë. Shfryente e nxehur. Ajo po pastronte plagën te këmba e një ushtari. Ai i thoshte vazhdimisht që ta mjekonte pak më me kujdes, përndryshe ishte më mirë ta qëllonte.

Tatiana iu afrua dhe e pyeti nëse kishte nevojë për ndihmë, por Brenda iu përgjigj se nuk i duhej ndihmë nga një vajzë e sëmure e cila mund t'i sëmurte më keq ushtarët, kështu që i kërkoi të kthehej menjëherë në dhomën e saj. Atëherë Tatiana qëndroi aty, vështroi Brendën dhe vrimën e hapur në këmbën e ushtarit.

- Më lër t'ia fashoj këmbën, - i tha Brendës. - Më lër të të ndihmoj ty. Shiko, kam vënë maskë mbi gojë dhe hundë. Katër burra të tjerë po të thërrasin nga ana tjetër e spitalit. Njëri humbi dhëmbët në kafe. Njëri ka temperaturë. Tjetrit po i del gjak nga veshi.

Brenda e lëshoi këmbën e ushtarit dhe u largua. Tatiana vuri re se për një çast Brenda nuk ishte e sigurt se çfarë e bezdiste më shumë: të kujdesej për ushtarët, apo fakti që Tatiana ia kishte arritur qëllimit.

Më në fund Tatiana ia pastroi plagën ushtarit, i cili nuk nxori zë dhe u përpoq që të qetësohej e ta zinte gjumi. Pastaj ia fashoi dhe vazhdoi tek ushtarët e tjerë.

Dezinfektoi një plagë në krah dhe një tjetër në kokë, ndërroi një serum dhe injektoi morfinë, duke dashur të kishte dhe pak morfinë për vete. Sa me fat ishin ushtarët e nëndetëses gjermane, që i kishin sjellë në Amerikë për t'i burgosur dhe për t'i mjekuar!

Papritur u shfaq Brenda, e cila, e çuditur që Tatiana ishte akoma aty, i tha të kthehej menjëherë në dhomën e saj, para se të infektonte të gjithë pacientët me tuberkuloz.

Ndërsa po kthehej në dhomë, pranë ftohësit të ujit pa një infermiere të gjatë e të hollë që po qante. Ishte shumë e bukur, me flokë të gjatë dhe me këmbë të gjata, por fytyrën e kishte të përlyer nga rimeli, që i kishte rrjedhur prej syve të saj të skuqur nga të qarët. Tatiana donte të pinte ujë, por iu desh të ndalonte pranë saj. Vajza qante me dënësë dhe, duke mos u përmbajtur, e kapi nga krahu dhe e pyeti:

- Je mirë?

- Po... - pëshpëriti vajza duke qarë.

- Aaa...

Vajza vazhdoi të qante. Në dorë mbante një cigare të lagur.

- E di se sa keq ndihem në këtë moment.

- A mund të bëj diçka për ty?

Ajo ngriti sytë e përлотur dhe e vështroi.

- Kush je ti?

- Mund të më thërrasësh Tanja.

- A nuk je ti ajo emigrantja me tuberkuloz?

- Tani jam më mirë, - u përgjigj me zë të ulët Tatiana.

- Nuk të quajnë Tanja. Unë i përgatita dokumentet e tua.

Tomi ma ngarkoi mua këtë detyrë. Të quajnë Xhein Barrington. Po mua ç'më duhet? Jeta ime është bërë copë e thërrime dhe unë rri e diskutoj se si të quajnë ty. Sa mirë do të ishte sikur të kisha problemet e tua!

Duke u përpjekur të gjente fjalët e duhura në anglisht për ta ngushëlluar, Tatiana i tha:

- Punët mund të ishin edhe më keq.

- E ke shumë gabim, vogëlushe. Më keq nuk bëhen. Nuk mund të më ndodhë gjë më e keqe. Asgjë.

Tatiana vuri re se vajza mbante në gisht unazën e martesës dhe iu dhimbs.

- Më fal... Ajo heshti. - Bëhet fjalë për burrin tënd?

Vajza pohoi me kokë.

- Është e tmerrshme, - tha Tatiana. - E di... Kjo luftë...

Tjetra tundi përsëri kokën.

- Kjo është e tmerrshme.

- Burri yt... nuk do të kthehet më?

- *Nuk* do të kthehet? - ngriti zërin vajza. - Pikërisht këtu qëndron problemi! Do të kthehet! Vjen javën tjetër.

Tatiana u habit nga ajo çka dëgjoji dhe bëri një hap prapa.

- Ku po shkon? Më duket sikur do të rrëzohesh, - i tha tjetra. - Nuk e ke ti fajin që ai do të kthehet. Ka dhe më keq. Dëshiron të pimë një kafe? Do një cigare?

- Në rregull, shkojmë të pimë një kafe, - iu përgjigj Tatiana.

Shkuan në sallën e ngrënies dhe u ulën në një prej tavolinave drejtkëndëshe. Vajza u prezantua:

- Viktoria Sabatela... Më thirr Viki. Dhe pasi i shtrëngoi dorën fort, e pyeti: - Ke ardhur me prindërit? Kam muaj që nuk kam



parë refugjatë të rinj. Anijet nuk sjellin më. Kaq pak... ç'është? Je e sëmurë?

- Jam më mirë tani, - foli me zë të ulët Tatiana. - Vetëm kam ardhur. Heshtje. - Me djalin tim.

- Mos më thuaj! - ngriti zërin Viki dhe përplasi gotën e saj në tavolinë. - Mos më thuaj që ke dhe djalë!

- Ka pothuajse një muaj...

- Sa vjeç je?

- Nëntëmbëdhjetë.

- Shumë herët filloni ju andej... Vërtet, nga je?

- Nga Bashkimi Sovjetik.

- Uau! Ku e gjete këtë djalë? Ke burrë?

Tatiana hapi gojën për të folur, por Viki vazhdoi sikur të mos e kish pyetur fare. Para se të ndalonte për të marrë frymë, ajo i tregoi se ajo nuk e kishte njohur të atin (*vdinq apo na braktisi, e njëjta gjë është*), të ëmën vetëm sa e kishte njohur (*më lindi kur ishte shumë e re*), se ajo tani jetonte në San Francisko me dy burra (*jo në të njëjtën shtëpi*), dhe hiqej sikur ishte e sëmurë (*po, mendërisht*) ose sikur po vdiste (*nga gjithë ai pasion!*). Vikin e kishin rritur prindërit e së ëmës (*e duan shumë mamanë, por nuk e pranojnë jetën që bën*) dhe akoma jetonte me ta (*nuk është dhe aq qejf sa duket*). Fillimisht donte të bëhej gazetare, pastaj manikyriste (*në të dyja profesionet punon me duar, kështu që mendova se ishte një progres i natyrshëm*), por përfundimisht vendosi (*ose më saktë, më detyruan*) të bëhej infermiere, kur u bë e ditur se edhe Shtetet e Bashkuara do të hynin në luftë. Tatiana e dëgjonte në heshtje, kur papritur Viki pushoi së foluri për veten dhe e pyeti:

- Ke burrë?

- Dikur.

- Ashtu? - psherëtiu Viki. - Dikur. Kjo shprehje, "që edhe unë kisha një burrë dikur"...

Në atë moment biseda e tyre u ndërpre nga një grua tepër e ngathët, shumë e gjatë, me një veshje të përsosur dhe me një kapelë të bardhë rrethore në kokë, e cila ecte duke tundur çantën dhe duke thirrur:

- Viki! Me ty e kam! Viki! E ke parë gjëkund?

Viki psherëtiu dhe i rrotulloi sytë nga Tatiana.

- Jo, znj. Lادلou. S'e kam parë fare sot. Më duket se është akoma në anën tjetër të qytetit, te NYU<sup>1</sup>. Të martave dhe të enjteve pasdite është aty.

- Pasditeve? S'është te NYU! E nga e ditke ti kaq mirë orarin e tij?

- U bënë dy vjet që punoj me të.

- E po unë kam më se tetë vjet që jam gruaja e tij dhe akoma nuk e di se ku është.

Iu afrua tavolinës dhe u qëndroi mbi kokë, duke i hedhur Tatianës një vështrim dyshues.

- Kush je ti?

Tatiana e vuri përsëri maskën mbi gojën e saj. Viki ndërhyri.

- Është nga Bashkimi Sovjetik. Nuk flet pothuajse fare anglisht.

- E po duhet të mësojë, apo jo? Nëse do të qëndrojë këtu. Jemi në mes të luftës, s'jemi në kushte të tilla për të mbështetur bebe.

Gruaja u largua me nxitim nga salla dhe gati sa nuk e goditi me çantën e saj Tatianën.

- Kush është ajo? - pyeti Tatiana.

Viki bëri një shenjë mospërfillëse me dorë.

- Mos u merr me të. Sa më pak të dish për të, aq më mirë është. Është gruaja e çmendur e dr. Lادلout. Vjen këtu pothuajse një herë në javë duke kërkuar të shoqin.

- Pse, ajo e ka humbur atë?

Viki qeshi.

- Pyetja më interesante do të ishte: "Pse dr. Lادلou vazhdon të humbasë kaq shpesh?"

- E po mirë, pse?

Viki iu përgjigj kësaj pyetjeje me një lëvizje të dorës. Tatiana e kuptoi. Ajo nuk donte të fliste për dr. Lادلoun. Tatiana e vlerësonte Vikin. Tani që kishte pushuar së qari, Tatiana vuri re se ajo, në fakt, ishte një vajzë shumë e bukur dhe këtë ajo e dinte shumë mirë, dhe bënte çfarë të mundej që ta dinin dhe të tjerët. Flokët e saj të gjatë, sytë e lyer me penel dhe rimel të zi, që edhe pse kishin rrjedhur përçark tyre, nuk e kishin humbur shkëlqimin e tyre. Uniforma e

---

<sup>1</sup>NYU, New York University.

saj e bardhë i rrinte ngjitur pas trupit dhe fundi i arrinte deri pak sipër gjurit. Tatiana pyeste veten se si reagonin të plagosurit ndaj një pamje të tillë.

- Viki, pse po qan? Ti nuk e dashuron burrin tënd?

- E dashuroj, e dashuroj, - psherëtiu. - Vetëm se do të doja ta dashuroja në një distancë prej pesë mijë miljesh. Uli zërin dhe vazhdoi sërish: - Nuk është momenti i përshtatshëm që të kthehet.

- Që burri të kthehet te gruaja e tij? Kur nuk është momenti i duhur për këtë?

- Nuk e prisja. Filloi përsëri të qante dhe ta hollonte kafënë me lotët e saj. Tatiana ia largoi filxhanin e kafesë, kështu që Viki mund ta pinte atë më vonë nëse donte.

- Kur e...? Si s'më kujtohet... A po e prisje?

- Për Krishtlindje!

- Pse po vjen më shpejt?

- Do ta besosh? U plagos në Paqësor!

Tatiana ia nguli sytë me habi.

- Oh, ai është në rregull, - tha Viktoria me mospërfillje. - Vetëm një gërvishtje në sup ka. Pasi u plagos, e pilotoi avionin edhe nëntëdhjetë milje të tjera. Sa keq mund të jetë?

Tatiana u ngrit.

- Duhet të shkoj të ushqej djalin.

- Po... Por Krisit do t'i vijë keq.

- Kush është Krisi?

- Doktor Pandolfi. Nuk e ke njohur? Vjen së bashku me doktor Ladloun.

Kris Pandolfi.

- Po, e kam njohur. Dr. Pandolfi ishte një prej mjekëve që kishin hipur në anijen me të cilën kishte ardhur Tatiana, i cili kishte vendosur se nuk do ta ndihmonte që ta lindte fëmijën e saj në tokën amerikane. Donte ta kthente mbrapsht në Bashkimin Sovjetik, megjithëse i kishin plasur ujërat, e sëmurë me tuberkuloz, me gjithë ato probleme që ajo kishte. Eduard Ladlou kishte thënë jo dhe e kishte transportuar në spitalin e ishullit Elis. Nuk ishte e sigurt nëse Kris Pandolfi ishte zgjedhja e duhur për Vikin. I ra supeve me dashamirësi dhe i tha:

- Ti do të jesh mirë, Viktoria. Ndoshta duhet të qëndrosh larg doktor Pandolfit. Je shumë me fat. Burri yt po kthehet.

Viktoria u ngrit dhe e ndoqi deri në dhomën e saj.

- Më thirr Viki, - i tha. - Mund të të thërras Xhein?

- Kush?

- A s'të quajnë Xhein?

- Më thirr Tanja.

- Pse të të thërras Tanja, përderisa emri yt është Xhein?

- Emri im është Tanja. Xhein është vetëm për dokumente. Ajo e kuptoi se Viki nuk ishte shumë e interesuar. - Më thirr si të duash.

- Kur do të largohesh?

- Të largohem nga...?

- Nga Elisi?

Para se të përgjigjej, Tatiana u mendua pak.

- Nuk besoj se do të largohem. Nuk kam ku të shkoj.

Viki hyri në dhomë dhe pa foshnjën që flinte në djepin e tij.

- Sa i vogël që është, - tha Viki e hutuar dhe pastaj vështroi flokët e verdhë të Tatianës. - Babai i tij ishte brun?

- Po.

- Si ndihesh tani që u bërë nënë?

- Po ja...

- Mirë, pra, kur të bëhesh mirë, dua që të vish me mua, të njohësh gjyshen dhe gjyshin tim. Ata i duan shumë fëmijët. Më thonë vazhdimisht të bëj një fëmijë. Zoti na ruajtë! - vështroi përsëri Antonin. - Është shumë i ëmbël. Sa keq që nuk e pa i ati.

Djali nuk bënte dot asgjë. As mund të lëvizte, as mund të kthente kokën. Ajo e kishte aq të vështirë ta vishte, saqë ndonjëherë e linte vetëm me pelena dhe e mbulonte me batanije. Ajo nuk kishte rroba për të, por vetëm disa këmisha nate të cilat ia kishte sjellë Eduardi. Lavdi Zotit, ishte verë dhe nuk kishte nevojë për shumë rroba, pasi koka e tij ishte shumë e madhe për të kaluar nga e çara e këmishës dhe krahët nuk i rrinin rehat në mëngët e gjata. Kërthiza ende nuk i ishte shëruar, kështu që ajo vazhdonte ta lante me një leckë. Nuk ishte dhe aq keq, por për t'i larë kokën ishte shumë e vështirë, ishte përtej aftësive të saj. Ai ishte i vogël dhe nuk bënte dot asgjë, nuk e ndihmonte fare Tatianën. Nuk mund të qëndronte drejt ose pa lëvizur atëherë kur duhej. Koka i varej dhe trupi i tij i rrëshqiste nga duart. Ajo jetonte me frikën se mos i rrëshqiste nga duart dhe i binte

mbi pllakat e dyshemesë. Kjo nevojë jetike e Antonit për ndihmën e saj, e bënte Tatianën jashtëzakonisht të shqetësuar dhe njëkohësisht e mbyste brishtësia e tij. Në njëfarë mënyre, dhe ndoshta ky ishte pikërisht qëllimi i natyrës, nevoja që kishte ai për të, e bënte Tatianën më të fortë.

Dhe ajo kishte nevojë të bëhej më e fortë. Shpesh, kur ai flinte, Tatianës i dukej sikur koka e saj e dobët do të varej dhe do të binte mbi pllakat e dyshemesë. Kështu, për të marrë pak forcë, zbulonte fytyrën e djalit dhe prekte lëkurën e tij. E merrte nga krevati dhe e shtrinte mbi gjoksin e saj. Ai ishte me gjymtyrë të gjata. Kur e përkëdhelte shpesh, imagjinonte sikur shihte një tjetër djalë nëpërmjet syve të së ëmës. Një bebe të gjatë sa Antoni, zeshkan si ai, të cilin e ëma e prekte, e lante dhe e përkëdhelte. Gjithë jetën e saj kishte pritur për këtë djalë.

## KAPITULLI VII

*Marrja në pyetje, 1943*

**D**ËGJOI zëra nga jashtë dhe dera u hap.

- Aleksandër Belov?

Aleksandri u bë gati të përgjigjej “po”, por për një arsye të pashpjegueshme i erdhi në mendje ekzekutimi i Romanovit, që u bë në mes të natës, në një bodrum të vogël. Ç’ ishte kjo në mes të natës? Në të njëjtën natë? Natën pasardhëse? Vendosi të mos fliste.

- Po, shkojmë tani.

Ndoqi pas rojën drejt një dhome të vogël që ndodhej lart. Nuk ishte një dhomë e mirëfilltë. Ngjante me një magazinë të vjetër, ndoshta si një sallë infermierie.

I thanë të ulej në një karrige. Pastaj i thanë të ngrihej. Përsëri të ulej. Jashtë ishte ende errësirë. Nuk mund ta kuptonte se sa ishte ora. Pyeti dhe si përgjigje mori vetëm një “Pusho!”. Vendosi të mos pyeste më.

Pesë minuta më vonë në dhomë hynë dy burra. Njëri prej tyre ishte trashaluaqi Miterand, ndërsa tjetrin nuk e njihnte. Ky i fundit i drejtoi një dritë të fortë në fytyrë sa gati e verboi. Ai mbylli sytë.

- Hapi sytë, major!

- Vladimir, - iu drejtua me zë të ulët trashaluaqi Miterand, - prit njëherë. Mund ta bëjmë me një mënyrë tjetër.

Atij i pëlqente që e thërrisnin major. Ashtu siç kishte dyshuar, në Morozovo nuk ekzistonte askush që të mund ta merrte në pyetje. Ajo që duhej të bënin, ishte ta merrnin e ta çonin në Volhov, ku gjërat për të do të ishin ndryshe, edhe pse ata nuk donin të vinin në rrezik jetën e burrave të tyre për të lëvizur përgjatë lumit. Ata kishin dështuar një herë. Përfundimisht do ta kalonin me ndonjë lundër, por më parë duhej të prisnin derisa të shkrinin akujt. Kjo do të thoshte se do të qëndronte edhe një muaj tjetër në atë qeli në Morozovo. A mund të duronte edhe një minutë aty?

- Major Belovi, - tha Miterandi, - erdha të të informoj se je nën arrest me akuzën për tradhti të lartë. Disponojmë dokumente të pamohueshme që ju akuzojnë për spiunazh dhe tradhti të lartë ndaj atdheut. Ç'keni për të thënë për këto akuza?

- Nuk kanë asnjë bazë, - u përgjigj Aleksandri. - Ndonjë gjë tjetër?

- Ju akuzoheni si agjent i huaj!

- Nuk është e vërtetë.

- Na kanë thënë se keni përdorur identitet të rremë.

- Nuk është e vërtetë, ky është identiteti im.

- Këtu përpara kemi një dokument që duhet ta nënshkruash. Në të shkruhet se u njoftove për të drejtat e tua sipas *Kodit Penal* të vitit 1928, neni 58.

- Nuk do të nënshkruaj absolutisht asgjë, - tha prerë Aleksandri.

- Pacienti i shtruar pranë teje në spital na tha se të dëgjoji të flisje anglisht me doktorin e Kryqit të Kuq, i cili të vizitonte çdo ditë. Është e vërtetë?

- Jo, nuk është e vërtetë.

- Përse erdhi t'ju vizitonte doktori?

- Nuk e di nëse e dini përse ushtarët shkojnë në pavijonin e rasteve kritike të një spitali; unë shkova pasi u plagosa në betejë. Ndoshta duhet të pyesni eprorët. Majorin Orlov...

- Orlovi ka vdekur! - u hodh Miterandi.

- Më vjen keq që po e dëgjoj këtë, - tha Aleksandri dhe u zbraps për pak. Orlovi ishte një komandant i zoti. Por jo aq sa Mihail Stepanov, si ai nuk kishte tjetër.

- Major, akuzohesh se u inkuadrove në radhët e ushtrisë me emër të rremë. Akuzohesh se je amerikan dhe quhesh Aleksandër Barrington. Akuzohesh se u arratisë kur po të transportonin në

një repart riedukimi në Vladivostok, i dënuar për spiunazh dhe veprimtari antisovjetike.

- Gënjeshtra keqdashëse, të gjitha, - tha Aleksandri. - Ku është ai që më akuzon? Do të doja ta shihja. *Sa kohë ka kaluar? Ka kaluar, të paktën, ajo natë? Kanë arritur të largohen Tatiana dhe Sejersi? Nëse ia kanë dalë, do ta kenë marrë me vete edhe Dimitrin.* NKVD-ja do ta ketë pasur shumë të vështirë të thotë se ekziston një akuzues, përderisa akuzuesi ishte zhdukur si një prej ministrave të kabinetit të byrosë politike të Stalinit.

- Do të doja ta sqaroja këtë situatë po aq sa edhe ju, - tha Aleksandri duke buzëqeshur me zor. - Ndoshta edhe më shumë se ju. Pra, ku është ai?

- Nuk do të na bësh ti pyetje! - ulëriti Miterandi. - Këtu pyetjet i bëjmë ne! Problemi ishte se nuk kishin pyetje të tjera. Dhe filluan të bënin përsëri të njëjtat pyetje: - Jeni ju amerikani i quajtur Aleksandër Barrington?

“Jo”, do të përgjigjej amerikani i quajtur Aleksandër Barrington. “Unë nuk e di çfarë po thoni”. Aleksandri nuk mund ta kuptonte se sa zgjati kjo gjë. Ata ia ndriçuan fytyrën me një elektrik dore dhe ai vazhdonte t’i mbante sytë të mbyllur. Pastaj e urdhëruan që të ngrihej, dhe këtë moment ai e shfrytëzoi për të çmpirë pak këmbët. Qëndroi me kënaqësi në atë pozicion për pothuajse një orë. Pastaj i erdhi keq kur i thanë të ulëj përsëri.

Nuk e dinte se kishte qëndruar plot një orë, por që ta përmbante veten kur t’i bënin të njëjtat pyetje, filloi të numëronte se sa do të zgjaste cikli pyetje-përgjigje: “Ju jeni amerikani i quajtur Aleksandër Barrington?” “Jo. Unë nuk e di për çfarë po flisni”.

Kjo zgjati shtatë sekonda. Nëse do të përgjigjej, nëse përplaste këmbët, nëse zgurdullonte sytë, nëse psherëtinte, atëherë do të zgjaste dymbëdhjetë sekonda. Po të gogësitej, atëherë do të zgjaste tridhjetë sekonda. Kjo do të bënte që koha të kalonte më shpejt.

Pyetjen ia përsëritën 147 herë. Miterandi duhej të pinte gjashtë herë për të vazhduar.

Por më në fund ia kaloi frenat Vladimirit, i cili pinte më pak, por punën e bënte shumë më mirë, madje duke e pyetur dhe Aleksandrin nëse donte të pinte dhe ai. Aleksandri refuzoi me shumë edukatë



dhe i qe mirënjuhës për këtë ndryshim në sjellje. Ai e dinte se nuk duhej të pranonte kurrë, çfarëdo që t'i ofronin.

Nuk ishte aspak argëtuese. Pas 147 herëve, me një zhgënjim që dallohej qartë në fytyrën dhe zërin e tij, Vladimiri tha:

- Roje, çoje në qelinë e tij. Dhe, në po atë moment, shtoi: - Ne do t'ju bëjmë të rrëfeheni, major. Ne e dimë se akuzat kundër jush janë të vërteta, por do të bëjmë gjithçka që ju të rrëfeheni.

Zakonisht, kur *aparatchikët* e Partisë hetonin të burgosurit me qëllim që t'i dënonin dhe t'i dërgonin nëpër kampet e punës së detyruar, të gjithë ishin në dijeni për parodinë që luhej; hetuesit dhe të burgosurit, të lodhur dhe të habitur, e dinin që akuzat ishin të rreme, por në fund, zgjidhjet alternative që u paraqiteshin ishin tejet të zymta dhe ata e kishin të pamundur të vazhdonin të mohonin akuzat e rreme. Na thoni, ju... që... keni... jetuar... pranë... një... antiproletari, se jeni bashkëpunëtorë me të, ose do të dënoheni për të jetuar njëzet e pesë vite në Magadan. Nëse ju do të pranoni, do të dënoheni vetëm dhjetë vjet. Kjo ishte zgjedhja për të burgosurit që pranonin të shpëtonin veten e tyre, ose familjet e tyre, ose për shkak të torturave dhe thyerjeve, ata paralizoheshin duke menduar një mori gënjeshtresh. Por Aleksandri pyeste veten: *A ishte kjo hera e parë pas disa dekadave që kur kishin filluar këto marrje false në pyetje, kur të burgosurit akuzoheshin për të vërtetën reale?* - pasi ai me të vërtetë ishte Aleksandër Barrington - ku marrja në pyetje për herë të parë kishte të bënte me të vërtetën, dhe e vërteta qëndronte aty përpara tyre, e vërteta që Aleksandri duhej të mohonte, e vërteta që Aleksandri, për të jetuar, duhej të varroste një mori gënjeshtresh. Ai u bë gati t'i tregonte Miterandit dhe Vladimirit, por menjëherë mendoi se ata as do ta kuptonin e as do ta vlerësonin ironinë e zymtë.

Pasi e kishin kthyer në qeli, dy roja erdhën me armët të drejtuara nga ai dhe e urdhëruan që të zhvishej.

- Erdhëm të të marrim uniformën, për ta larë, - i thanë ata. Aleksandri mbeti vetëm me të brendshmet. Rojat e urdhëruan të hiqte orën, çizmet dhe çorapet. Por çorapet nuk pranoi t'i hiqte, pasi dyshemeja e qelisë ishte aq e ftohtë, sa mund t'i ngrinin këmbët.

- Ç'ju duhen çizmet e mia? - pyeti ai.

- Që t'i lyejmë, - iu përgjigjën ata.

Aleksandri i ishte mirënjohës dr. Sejersit për parashikimet e tij, që të mos e fshihte morfinën në çizme, por te të brendshmet.

Ua zgjati çizmet me hezitim, por ata ia rrëmbyen dhe u larguan pa thënë asnjë fjalë.

Pasi ishte mbyllur dera dhe kishte mbetur vetëm, Aleksandri mori llambën me vajguri dhe e afroi pranë trupit, që të ngrohej paksa. Nuk i bënte aspak përshtypje fakti se në qeli sasia e oksigjenit po zvogëlohej.

Roja e pa dhe i bërtiti, duke i thënë të mos e prekte llambën. Por ai as që e uli atë poshtë. Atëherë roja hyri në qeli dhe ia mori, duke e lënë përsëri në errësirë e në të ftohtë.

Megjithëse Tatiana ia kishte mjekuar mirë plagën në shpatull, ajo tani po i pulsonte. Fashat me të cilat ia kishte lidhur, tashmë i ishin mbështjellë rreth stomakut. Do të dëshironte që, po të kishte mundësi, ta mbështillte të gjithë trupin me ato fasha të bardha.

Aleksandri kishte nevojë që trupi i tij të kishte sa më pak kontakt me të ftohtin. Qëndronte në mes të qelisë me këmbët të vendosura në dyshemenë e ftohtë dhe për një moment imagjinonte sikur ndodhej në një qeli të ngrohtë.

Duart i vendoste herë prapa kokës, herë pas shpatullave dhe herë para gjoksit.

Dhe imagjinonte...

*Tanja qëndronte para tij, me kokën të mbështetur në gjoksin e zhveshur, duke dëgjuar rrahjet e zemrës së tij. Pastaj ngrinte kokën dhe e vështronte duke buzëqeshur. Qëndronte në majë të gishtave e mbështetur në krahët e tij, duke u zgjatur drejt qafës...*

Ngrohtësi.

Nuk ekzistonte as mëngjes dhe as natë. Nuk ekzistonte as ndriçim dhe as dritë. Nuk kishte asgjë për të matur kohën. Imazhi i saj nuk largohej për asnjë çast, dhe ai nuk mund ta maste kohën që shpenzonte duke menduar për të. U përpoq të numëronte... por e kuptoi që ishte e pamundur, pasi ishte tejet i lodhur. Kishte nevojë për gjumë.

Gjumë apo ftohtë? Gjumë apo ftohtë?

Gjumë.

U mblodh kruspull në një qoshe të qelisë dhe u shkund pa vetëdije për të larguar nga mendja trishtimin dhe dhimbjen. Ishte dita pasardhëse, apo nata pasardhëse?

Dita pasardhëse, pas cilës ditë? Nata pasardhëse, pas cilës natë?  
*Ata do të më lënë të vdes nga uria. Do të më lënë të vdes nga etja. Atëherë do të më rrahin për vdekje. Por fillimisht do të më ngrijnë këmbët, pastaj kofshët, pastaj organet e brendshme dhe çdo gjë do të shndërrohet në akull. Edhe gjaku im, edhe zemra ime, dhe unë do të harroj...*

### *Tamara dhe historitë e saj, 1935*

Ekzistonte një *babushkë* e vjetër e quajtur Tamara, e cila kishte njëzet vjet që jetonte në katin e tyre. Dera e saj ishte gjithnjë e hapur. Shpeshherë, kur Aleksandri kthehej nga shkolla, ndalonte për të biseduar me të. Kishte vënë re se asaj i pëlqente shoqëria me më të rinjtë. Ajo iu dha mundësinë atyre që të ndikoheshin nga përvoja e jetës së saj. Një pasdite, e ulur në një karrige druri të parehatshme pranë dritares, Tamara i tregoi Aleksandrit për bashkëshortin e saj të arrestuar në vitin 1928, për arsye fetare, të cilit i kishin dhënë dhjetë vjet...

- Prit pak, Tamara Mihailovna, dhjetë vjet ku?
- Punë të detyruar në një kamp, natyrisht. Në Siberi, ku tjetër?
- Ata e dënuan dhe e dërguan atje për punë?
- Në burg...
- Për të punuar si vullnetar?
- Oh, Aleksandër, ju më ndërpretë, por unë duhet t'ju them diçka. Ai heshti.

- Prostitutat pranë Arbatit u arrestuan në vitin 1930 dhe, jo vetëm që u kthyen në rrugë muaj më vonë, por u ribashkuan me familjet e tyre në qytetet e vjetra ku i frekuentonin më shpesh. Ndërsa bashkëshorti im dhe grupi i burrave besimtarë nuk u lejuan të kthehen, sigurisht jo në Moskë.

- Vetëm tre vjet më shumë? - pyeti Aleksandri ngadalë. - Vetëm tre vjet punë të detyruar.

Tamara tundi kokën dhe me zë të ulët iu përgjigj:

- Më 1932, mora një telegram nga autoritetet e kampit të Kolimës - *pa të drejtë përgjigjeje*. Ju e dini ç'do të thotë kjo?

Aleksandri nuk donte as ta merrte me mend.

- Kjo do të thoshte se nuk jetonte më, pra, që të mund t'i ktheja përgjigje, - tha Tamara me kokën ulur dhe me zërin që i dridhej. Ajo i tregoi se në kishën aty pranë ishin arrestuar tre priftërinj, të cilët u dënuan me shtatë vjet burg, pasi kishin predikuar parimet e kapitalizmit, që në rastin e tyre ishin besimi vetjak dhe i organizuar te Jezu Krishti.

- Edhe në kampin e punës së detyruar?

- Oh, Aleksandër! Ai pushoi së foluri, ndërsa ajo vazhdoi: - Por gjëja më qesharake është - a e keni vënë re rrugën para hotelit ku rrinin prostitutat para disa muajsh?

- Hëm... - pëshpëriti Aleksandri.

- A e keni vënë re se si u zhdukën të gjitha?

- Hëm... - pëshpëriti sërish Aleksandri duke pohuar se kishte vënë re gjithçka.

- I çuan larg. Për prishje të qetësisë publike...

- Dhe për mospredikim të parimeve të kapitalizmit, - tha pa qejf Aleksandri. Tamara qeshi dhe i përkëdheli kokën.

- Ke të drejtë, biri im. Ke të drejtë. Dhe, a e dini se sa u dënuan për të punuar në kampin e punës së detyruar? Tre vjet. Kujtohu: priftërinjtë, Jezu Krishti dhe shtatë prostitutat.

- Dakord, - tha Xheini, e cila, sapo hyri në dhomë, e kapi të birin për dore dhe e nxori jashtë. Para se të largohej, ajo u kthye dhe i tha me një ton akuzues Tamarës, por njëkohësisht i adresoi edhe Aleksandrit: - A është mundur të mos informohemi për prostituta nga gra të moshuara dhe pa dhëmbë në gojë?

- Mama, nga kush duhet të mësoj për prostitutat? - e pyeti ai.

- Biri im, mamaja jote donte të të fliste për diçka, - shqiptoi Haroldi duke pastruar fytyrën. Aleksandri rrudhi buzët dhe nuk foli. I ati nuk ndihej rehat ngaqë i duhej të bënte këtë bisedë serioze me të. E ëma bënte sikur pastronte në pjesën tjetër të dhomës. Haroldi i hodhi asaj një vështrim të egër.

- Baba? - pyeti Aleksandri me një zë të fortë, që para disa muajsh kishte filluar t'i trashej. Ky ndryshim i pëlqente shumë. Tashmë ishte rritur. Gjithashtu, gjatë gjashtë muajve të fundit, ishte zgjatur më shumë se tetë inç, por nuk dukej se kish vënë pak mish mbi kockat e tij. - Baba, dëshiron të dalim shëtitje dhe të bisedojmë për këtë gjë?

- Jo! - foli Xheini. - Unë nuk do t'ju dëgjoj. Bisedoni këtu.

Aleksandri tundi kokën dhe tha:

- Dakord, baba, bisedojmë këtu. Atij iu mblodh një lëmsh në grykë dhe u përpoq të ruante seriozitetin. Nuk kishte rëndësi nëse rrinin me sy ulur apo të kryqëzuar. Haroldi nuk e vështronte drejt Aleksandrin.

- Bir, - tha Haroldi, - tani ti je i rritur, unë jam i sigurt, ti je... një djalë i mirë dhe i paraqitshëm. Dua të të ndihmoj, biri im, dhe tashmë unë jam i sigurt se ti je...

Xheini u largua nga dhoma dhe Haroldi u ndje më i qetë.

Aleksandri qëndroi i ulur për pak sekonda, pastaj u ngrit, i ra supeve dhe i tha:

- Faleminderit, baba! Vërtet që kjo bisedë *qe* e dobishme.

Aleksandri shkoi në dhomën e tij, ndërsa Haroldi nuk e ndoqi pas. Pak më vonë dëgjoi pas derës prindërit e tij të grindeshin dhe pas një minute dikush trokiti në dhomën e tij. Ishte e ëma.

- A mundem të bisedoj me ty?

Aleksandri u përpoq të mos ndryshonte shprehjen e fytyrës, por iu përgjigj menjëherë:

- Mama, besoj vërtet se babai i tha të gjitha ato që duheshin thënë, nuk e di nëse ke gjë për të shtuar...

Ajo u ul në shtratin e tij, ndërsa ai qëndroi i ulur në një karrige pranë dritares. Në maj ai mbushte gjashtëmbëdhjetë vjeç. I pëlqente vera. Ndoshta do të merrnin ndonjë dhomë në *dacha*, në Krasnaja Poliana, siç bënë vitin e kaluar.

- Aleksandër, çfarë nuk të përmendi babai yt...

- *Kishte* ndonjë gjë që babai nuk e përmendi?

- Bir...

- Të lutem... vazhdo.

- Unë nuk kam ndër mend të të bëj leksion për vajzat...

- Falënderoj Zotin për këtë.

- Më dëgjo mua, të vetmen gjë që dua të bësh është të mbash mend këtë... Ajo heshti.

Ai po priste.

- Marta më tregoi se njërit prej djemve të rrugës ia prenë... - pëshpëriti ajo. - *Ia prenë*, Aleksandër, dhe a e di pse?

- Nuk jam i sigurt, por do të doja ta dija.

- Sepse u infektua me sëmundjen veneriane. A e di se ç'lloj sëmundjeje është kjo?

- Mendoj...

- Dhe djali tjetër i saj u infektua me sifiliz. I gjithë trupi iu mbushu me njolla. Kjo të revoltonte pa masë!

- Po, kjo...

- Sëmundje e mallkuara! Sifilizi! Lenini vdiq nga sifilizi, i preku trurin, - pëshpëriti ajo. - Askush nuk e tha, pavarësisht se është e vërtetë. Është kjo ajo që dëshiron?

- Hëm... - pëshpëriti Aleksandri. - Ashtu?

- Po kjo ndodh gjithandej. Unë dhe babai yt njohëm një burrë që ia gërreu hundën.

- Personalisht, do të dëshiroja më mirë të humbisja hundën se...

- Aleksandër!

- Më fal!

- Kjo është shumë serioze, biri im. Unë jam përpjekur që të bëhesh një djalë i mbarë, të jesh i pastër dhe i shëndetshëm, por shiko se ç'po ndodh? Së shpejti do të veprosh me kokën tënde.

- Sa shpejt mendon ti?

- Çfarë mendon se do të ndodhë kur ti nuk e di se me kë mund të ketë shkuar një prostitutë? - pyeti Xheini me këmbëngulje. - Bir, kur të rritesh, unë nuk dua të jesh një shenjt apo një eunuk. Ajo që dëshiroj unë, është të tregohesh i kujdesshëm. Dëshiroj që ti të jesh i mbrojtur gjatë gjithë kohës. Ti duhet të jesh i pastër, vigjilent dhe, gjithashtu, duhet ta mbash mend se nëse nuk përdor profilaktikë, do të të ngecet ndonjë vajzë... dhe pastaj ç'do të ndodhë? Ti do të martohesh me dikë që nuk e dashuron, vetëm sepse nuk u tregove i kujdesshëm?

Aleksandri po e shikonte ngulazi të ëmën.

- Të më ngecë? - tha ai.

- Ajo do të të thotë se është fëmija yt, edhe pse ti kurrë nuk do të jesh i sigurt për këtë. Ajo që do të dish është që jeni të martuar dhe çdo gjë ka marrë fund!

- Mama, - tha Aleksandri. - Është më mirë të mos e vazhdojmë më këtë bisedë.

- A e kupton çfarë dua të të them?

- Si nuk mundem ta kuptoj?

- Babai u përpoq të ta shpjegonte.
- Ai e kreu detyrën e tij. Dhe e bëri shumë mirë.
- Xheini u ngrit.
- A mund t'i lësh ndonjëherë shakatë?
- Po, mama. Faleminderit që erdhe. Jam i kënaqur që e bëmë këtë bisedë.
- Ke ndonjë pyetje?
- Absolutisht asnjë.

### *Ndryshimi i emrit të hotelit, 1935*

Një të enjte të acartë, nga fundi i janarit, kur po shkonin në mbledhjen e Partisë, Aleksandri pyeti të atin:

- Baba, pse ia ndërruan sërish emrin hotelit tonë? Është hera e tretë që ndodh kjo gjë brenda gjashtë muajve.

- Nuk është hera e tretë!

- Po, baba. Ata po ecnin përkrah njëri-tjetrit. - Sapo erdhëm këtu, quhej “Derzhava”. Pastaj e quajtën “Kamenev”. Më vonë “Zinoviev”. Ndërsa tani mban emrin “Kirov”. Pse? Dhe kush është ky Kirovi?

- Ishte kryetari i Partisë së Leningradit, - u përgjigj Haroldi.

Në mbledhje, një plak i quajtur Slavani, u shkri së qeshuri kur dëgjoi Aleksandrin të përsëriste pyetjen e tij. E afroi pranë vetes, i ledhatoi kokën dhe i tha:

- Mos u shqetëso, biri im. Tani do të mbetet “Kirov”. Nuk do ta ndërrojë më.

- Dakord, mjaft! - ndërhyri Haroldi duke u përpjekur ta largonte të birin nga plaku. Por Aleksandri donte të dinte më shumë për të. E largoi dorën e të atit dhe e pyeti:

- Pse, Slavan Ivanoviç?

- Sepse Kirovi ka vdekur - u përgjigj Slavani. Ai tundi kokën. - E vranë në Leningrad muajin e kaluar dhe tani janë në kërkim.

- Nuk e kapën vrasësin? - pyeti Aleksandri.

- Kriminelin e kapën, - u përgjigj plaku duke buzëqeshur me njëfarë vetëkënaqësie. - Por jo të tjerët.

- Cilët të tjerë? - uli zërin Aleksandri.

- Komplotistët e tjerë, - tha plaku. - Duhet të vdesin të gjithë.

- Pra ishte komplot?

- Natyrisht. Përndryshe, pse do të ishin në kërkim?

Haroldi i thirri menjëherë Aleksandrit që të shkonte pranë tij. Dhe më vonë, kur u kthyen në shtëpi, i tha:

- Bir, pse u miqësove kaq shumë me Slavanin? Çfarë të tha?

- Baba, është mjaft interesant! - u përgjigj Aleksandri. - E di që ka kaluar pesë vite në Akatui? Akatui ka qenë një kamp siberian carist për punë të detyruar. Ai thotë se i kishin dhënë një këmishë të bardhë për të punuar tetë orë në ditë në verë dhe gjashtë orë në dimër. Asnjëherë nuk e bënte pis këmishën e tij. Madje i jepnin një kilogram bukë të bardhë në ditë dhe mish. Gjithashtu thekson se ato ishin vitet më të mira të jetës së tij.

- Nuk do ta lakmonte askush, - u përgjigj duke shfryrë Haroldi. - Më dëgjo se ç'do të të them: nuk dua të flasësh kaq shumë me të. Të qëndrosh me ne.

- Hëm, - ia bëri Aleksandri, - ju tymosni vazhdimisht dhe mua më djegin sytë.

- Ne nuk shkojmë nga fryn era. Slavani vazhdimisht krijon probleme. - Qëndro larg tij, më dëgjon? Ai heshti për pak. - Ai nuk e ka të gjatë.

- Ç'do të thotë kjo?

Pas dy javësh Slavani u zhduk nga mbledhjet.

Aleksandrit i mungoi plaku dhe historitë e tij.

- Baba, nga kati ynë vazhdimisht zhduken njerëz të ndryshëm. Ja, ajo zonja e mirë, Tamara, u zhduk.

- Kurrë nuk më pëlqeu ajo, - u hodh Xheini duke kthyer një gllënjë vodka. - Do të jetë sëmurë dhe do ta kenë shtruar në spital. E moshuar ishte, Aleksandër.

- Mama, tani në dhomën e saj banojnë dy burra të rinj me kostume. Do të banojnë së bashku kur ajo të dalë nga spitali?

- Nuk ia kam idenë, - u përgjigj e vendosur Xheini dhe e mbushi sërish gotën me vodka.

- Edhe italianët kanë ikur. Mama, e dije që edhe italianët u zhdukën?

- Kush? - tha Haroldi me zë të lartë. - Kush u zhduk? Frashkët nuk janë zhdukur. Kanë shkuar me pushime.

- Baba, është dimër. Ku kanë shkuar me pushime?



- Në Krime. Në një kompleks turistik afër Krasnodarit. Dzhugba, më duket se quhet. Do të kthehen pas dy muajsh.

- Ashtu? Po Van Dorenët, ku kanë shkuar? Edhe ata në Krime? Edhe në dhomën e tyre tani banojnë disa të tjerë. Një familje ruse. Mendoja se ky kat ishte vetëm për të huajt.

- U transferuan në një ndërtesë tjetër në Moskë, - u përgjigj Haroldi duke përzier gjellën e tij. - Obkomi po përpiqet të integrojë të huajt në shoqërinë sovjetike.

Aleksandri lëshoi pirunin nga dora.

- Janë transferuar? Ku janë transferuar? Sepse Nikita fle në banjën tonë?

- Kush është Nikita?

- Baba, nuk e ke vënë re që në vaskë fle një njeri?

- Cili?

- Nikita.

- Ashtu... Sa kohë ka?

- Tre muaj, - u përgjigj Aleksandri dhe i hodhi së ëmës një vështrim të zbrazët.

- Ka tre muaj që fle në vaskën tonë? Pse?

- Sepse në të gjithë Moskën nuk ka asnjë dhomë që ta marrë me qira. Ka ardhur këtu nga Novosibirsku.

- Nuk e kam parë fare, - u përgjigj Haroldi me një ton sikur donte të thoshte se përderisa nuk e kishte parë ai, atëherë nuk ekzistonte.

- Dhe, çfarë bën ai kur unë dua të bëj dush?

- Oh, ikën për një gjysmë ore, - u përgjigj Xheini. - I jap një gotë vodkë dhe del shëtitje.

- Mama, - u hodh Aleksandri, i cili po hante me oreks, - në mars do të vijë edhe e shoqja. Më kërkoi që t'u lutem të gjithëve në kat, të bëjnë dush më herët në darkë, që të kenë pak...

- Dakord, ju të dy po më ngacmoni mua! - thirri Haroldi.

Aleksandri dhe e ëma u vështruan në heshtje, pastaj ai shtoi:

- Baba, shko shikoje vetë. Dhe kur të kthehesh, më trego se ku mund të jenë transferuar Van Dorenët në Moskë.

Haroldi u kthye duke ngritur supet.

- Ai njeri është një rrugaç. Nuk vlen për asgjë.

- Ai njeri, - u përgjigj Aleksandri dhe vështrroi gotën e të ëmës, - është kryeinxhinieri i flotës së Baltikut.

Një muaj më vonë, në shkurt të vitit 1935, kur Aleksandri po kthehej nga shkolla, dëgjo i prindërit e tij të grindeshin me njëri-tjetrin. I dëgjo i disa herë të përmendnin emrin e tij.

E ëma ishte tronditur rreth diçkaje që kishte të bënte me Aleksandrin. Por ai ishte për bukuri. Tashmë fliste rrjedhshëm rusisht. Këndonte me shokët e tij, pinte birra bashkë me ta dhe luante hokej në akujt e parkut “Gorki”. Gjithçka shkonte mirë. Pra, përse mërzitej ajo? Donte të hynte brenda dhe t’i thoshte se ishte shumë mirë, por nuk i pëlqente të përzihej në sherret e prindërve të tij.

Papritur dëgjo i diçka të binte përtokë dhe pastaj një të goditur. Vrapoi për në dhomën e prindërve dhe pa të ëmën të rrëzuar në dysheme me faqen të skuqur dhe të atin të përkulur mbi të.

- Baba, ç’po bën aty? - bërtiti ai dhe ra në gjunjë pranë së ëmës.

Ajo u ngrit përgjysmë dhe vështroi Haroldin.

- Shembull të bukur po i jep tët biri. Për këtë e solle në Bashkimin Sovjetik, që t’i tregosh se si sillen burrat ndaj grave? Se si të sillen me gruan e tij nesër?

- Qepe! - ngriti zërin Haroldi duke shtrënguar grushtet.

- Baba! - ulëriu Aleksandri duke kërcyer në këmbë. - Mjaft!

- Aleksandër, babai yt na braktisi.

- Nuk ju braktisa!

Duke drejtuar trupin, Aleksandri i dha një të shtyrë të atit në gjoks.

Haroldi e shtyu tutje Aleksandrin dhe pastaj i dha një shpullë të fortë në fytyrë. Xheini lëshoi një britmë. Aleksandri u lëkund, por nuk u rrëzua. Ai u bë gati t’i gjuante përsëri, por këtë herë Aleksandri bëri mbrapsht. Xheini e kapi Haroldin nga këmbët dhe e rrëzoi përtokë.

- Mos guxo ta prekësh! - ulëriti ajo.

Haroldi dhe Xheini gjendeshin të shtrirë në dysheme, ndërsa Aleksandri qëndronte në këmbë. Ata nuk mund ta shihnin njëri-tjetrin në sy; mezi merrnin frymë. Aleksandri fshiu me dorë buzën e tij të gjakosur.

- Harold, - foli Xheini ende e rrëzuar në gjunjë, - na vështro! Ky vend i mallkuar po na shkatërron! Filloi të qante. - Shkojmë në shtëpinë tonë, t’ia nisim nga e para.

- U çmende? - i tha nëpër dhëmbë ai duke vështruar herë Aleksandrin, herë atë. - E kupton se ç'po thua?

- E kuptoj.

- E harrove që ne hoqëm dorë nga shtetësia amerikane? Harrove që për momentin nuk kemi asnjë shtetësi; se jemi duke pritur për të marrë shtetësinë sovjetike? Kujton se Shtetet e Bashkuara do të na pranojnë po të kthehemi mbrapsht? Pasi na zbuani, pothuajse me shkëlma? Dhe ç'mendon se do të thonë autoritetet sovjetike kur të marrin vesh se po u kthejmë shpinën atyre?

- Nuk më intereson se çdo të thonë autoritetet sovjetike!

- O Zot, sa naive që je!

- Po nëse unë jam naive, *ti* çfarë je? Ndërkohë që e dije se kështu do të ishte gjendja, përse na solle këtu? Solle djalin tënd këtu!

Haroldi i hodhi një vështrim që shprehte zhgënjim.

- Nuk erdhëm këtu për një jetë të rehatshme. Atë mund ta kishim dhe në Amerikë.

- Dhe e kishim, por e braktisëm. Ne mund të përshtatemi në këtë vend, por ky vend nuk është për Aleksandrin. Harold, ktheje *atë*, të paktën në shtëpi.

- Çfarë? - zëri i Haroldit doli si një pëshpërimë, nuk kishte kurajën të fliste me zë të lartë.

- Po! Ajo u ngrit nga dyshemeja duke u mbajtur nga Aleksandri dhe qëndroi para Haroldit. - Është pesëmbëdhjetë vjeç. Ktheje në atdhe.

- Mama! - foli Aleksandri.

- Mos e lër të vdesë në këtë vend... nuk shikon ç'po ndodh përreth? Aleksandri shikon. Unë shikoj. Po ti, pse nuk mund të shikosh?

- Aleksandri nuk shikon asgjë. Apo jo, bir?

Aleksandri nuk foli. Nuk donte t'i dilte kundër të atit.

- I sheh? - bërtiti Xheini triumfuese. - Të lutem, Harold. Pas pak do të jetë shumë vonë.

- Po thua gjepura! Shumë vonë për çfarë?

- Shumë vonë për Aleksandrin, - iu përgjigj Xheini me një zë të mekur nga dëshpërimi. - Për hatrin tim lëre për pak mënjane krenarinë tënde. Sapo të mbushë gjashtëmbëdhjetë vjeç në maj, i duhet të regjistrohet në Ushtrinë e Kuqe. Para se të na zërë të gjithëve përfund tragjedia, ktheje në atdhe për sa kohë është akoma qytetar

amerikan. Ai nuk i mohoi të drejtat e tij si qytetar i Amerikës. Unë do të jetoj me ty. Do të jetoj gjithë jetën pranë teje, por atë...

- Jo! - thirri Haroldi me një zë të tmerrshëm. - Vërtet, gjërat nuk janë ashtu si shpresoja, më vjen keq...

- Mos të të vijë keq për mua. Unë shtrihem pranë teje në këtë shtrat. E di shumë mirë se çfarë bëj. Të të vijë keq për djalin tënd. Ç'mendon se do të ndodhë me të?

Xheini u kthye nga Haroldi.

Aleksandri u kthye nga prindërit e tij. U afrua te dritarja dhe e hodhi vështrimin jashtë. Ishte një natë shkurti.

Pas vetes dëgjonte zërat e të ëmës dhe të atit.

- Eja këtu, Xhein. Çdo gjë do të shkojë për bukuri, do ta shohësh. Është më mirë këtu për Aleksandrin. Komunizmi është e ardhmja e njerëzimit, ti e di më mirë se unë. Sa më shumë të thellohet hendeku midis të pasurve dhe të varfërve, aq më i domosdoshëm do të bëhet komunizmi. Amerika është një çështje e humbur. Kush tjetër përveç komunizmit do të interesohet për njeriun e thjeshtë? Kush do t'i mbrojë të drejtat e tij? Tani po kalojmë fazën më të vështirë. Por unë nuk kam asnjë dyshim që... komunizmi është e ardhmja.

- O Zot! - ulëriti Xheini. - Kur do të heqësh dorë prej këtyre?

- Nuk mund të heq dorë. Do ta çojmë deri në fund kauzën tonë.

- Ashtu është, - u përgjigj Xheini. - Marksi ka shkruar, mbi të gjitha, se kapitalizmi i prodhon vetë varrmihësit e tij. Mos ndoshta ai e kishte fjalën për komunizmin?

- Pikërisht ashtu, - miratoi Haroldi, ndërkohë Aleksandri po vështronte në një tjetër drejtim. - Komunistët nuk i fshehin mendimet dhe qëllimet e tyre. E deklarojnë hapur se qëllimi i tyre do të përmbushet kur të përmbysen me dhunë të gjitha rrethanat ekzistuese. Rënia e kapitalizmit është e pashmangshme. Zhdukja e egoizmit, lakmisë, individualizmit dhe kërkesave personale!

- Zhdukja e mirëqenies, e rehatisë, e kushteve njerëzore të jetesës, e individualitetit, e lirisë, - tha Xheini duke pështyrë, ndërsa Aleksandri vazhdonte të vështronte nga dritarja. - Amerika e dytë, Harold. E mallkuara Amerikë e dytë!

Pa e kthyer kokën, Aleksandri pa në xham të pasqyrohej fytyra e egërsuar e të atit, pa fytyrën e dëshpëruar të së ëmës, dhomën ngjyrë gri me suvatë e rëna, bravën e thyer që e kishin ngjitur me